



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit me Karakter Profesional

“Programim në Web”

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “Bedër”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof As. Ariana Bejleri
2. Dr. Blerta Leka (Moçka)

Qershor/ 2023

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 1

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për programin e studimit me karakter profesional në “Programim në Web” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “Bedër”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Univesitar “Bedër”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Kompjuterike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program Profesional “Programim në Web”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 184 datë 03.07.2020
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Në proces
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Profesional 2-vjeçar
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite/ 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/ PAK për programin e studimit:	8 PAE/ 6 PAK v.a. 2022-2023 6 PAE/ 6 PAK v.a. 2021-2022
18	Numri i studentëve:	14 Studentë v.a. 2021-2022 16 Studentë v.a. 2022-2023
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar "Bedër" (KU Bedër) është një institucion jopublik i arsimit të lartë, i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 286, datë. 06.04.2011 me emërtimin Shkollen e Lartë Private "Hëna e Plotë (Bedër)". KU Bedër i është akorduar akreditimi i parë institucional dhe i programeve të studimit me Urdher Nr. 223, datë 04.06.2013. Akreditimi institucional është bërë në përputhje me vendimin nr. 469, date 03.05.2013 të Këshillit të Akreditimit.

KUB është riakredituar nga ASCAL me anë të Vendimit të BA Nr. 101, datë 10.11.2017 dhe më pas sipas Vendimit të BA Nr. 57, datë 16.12.2021 për një periudhë 5 vjeçare deri në 15.12.2026.

Hapja e programit të studimit me karakter profesional "Programim në Web" është realizuar nëpërmjet Urdhërit të MASR Nr. 184, datë 3.7.2020. Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Shkencave Kompjuterike, njësi përbërëse e Fakultetit të Teknologjise dhe Biznesit.

Programi i studimit me karakter profesional "Programim në Web" ofrohet me kohë të plotë në gjuhën shqipe, me kohëzgjatje 2 vite akademike të ndara në 4 semestra dhe është organizuar në bazë të sistemin Europian të transferimit të krediteve në 120 kredite ECTS. Çdo vit akademik përmban 60 kredite të ndara nga 30 kredite në semestër. Qëllimi i këtij programi studimi është përgatitja e specialisteve të kualifikuar në përdorimin e teknologjive më bashkëkohore të internetit dhe Web-it.

Programi i studimit ofrohet në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e KU Bedër.

KUB ka aplikuar në ASCAL për akreditimin e programit të studimit me karakter Porofesional "Programim në Web" me Nr. 210 Prot, më datë 01.06.2022 ndërsa dosja e dokumentacionit të akreditimit është dërguar në 10.02.2023. Në këtë mënyrë, kemi të bëjmë me akreditimin e parë të këtij programi studimi.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Përshkrim përmbledhës;

Burimi parësor i informacionit për GVJ-ne ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i përgatitur në periudhën Janar-Shkurt 2023. Ky Raport siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur KU Bedër për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. KU Bedër, po ashtu, nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL, vuri në dispozicion të vlerësuesve një numër eviencash mbështetëse.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr.531, datë 11.9.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, në VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, në Udhëzimin e MASR Nr. 1, datë 14.1.2020, për “Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë”, Udhëzimin e MASR Nr. 22, datë 3.9.2020, Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020, “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë” si dhe gjithë aktet e tjera nënligjore që kanë të bëjnë me organizmin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë.

GVJ gjatë vlerësimit të jashtëm u mbështet nga specialistja e ASCAL, Msc. Aviola Bardhi. Takimet në institucion, u zhvilluan sipas programit të miratuar nga ASCAL. Takimet në institucion konsistuan në zhvillimin e diskutimeve, me Dekanin e Fakultetit të Teknologjise dhe Biznesit, Përgjegjësin e Departamentit të Shkencave Kompjuterike, takim me grupin e vlerësimit të brendshëm për programin e studimit, takim me staf akademik të angazhuar në programin e studimit, takim me studentët në këtë program studimi. GVJ zhvilloi takime me përfaqësues të Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Drejtorisë së Komunikimit dhe Drejtorisë së Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Drejtorisë së Kurrikulës. Gjithashtu u zhvillua edhe një vizitë e auditorëve, laboratorëve si dhe bibliotekës, shoqëruar me diskutime për elementë lidhur me këtë infrastrukturë. Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e syllabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kualifikimin e stafit akademik, etj. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet shtesë që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave të paraqitura.

Më datë 02/06/2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 81/15 Prot., datë 02/06/2023, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. KU “Bedër” kthehu përgjigje në AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 180/1 Prot., datë 05/06/2023.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.



Vlerësimi i Programit të studimit me karakter profesional në “Programim në Web”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Misioni i Kolegjit Universitar “Bedër” është të përgatisë individë të kualifikuar, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe mbarë shoqërisë. Pjesë e misionit të KU Bedër është të kontribuojë në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Kolegji Universitar Bedër, GVJ konstaton se programi i studimit nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Gjithashtu, pjesë e misionit të Departamentit të Shkencave Kompjuterike, që ka si program studimi 2-vjeçar me karakter profesional në “Programim në Web” është përgatitja e individëve të kualifikuar duke përdorur teknologjitë më bashkëkohore të internetit dhe Web-it.</p> <p>Nga shqyrtimi i Statutit të KU “Bedër” dhe planit strategjik vlerësohet se programet e studimit, synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 10 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër (1), neni 4, pika 1]</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 10 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër (1), neni 4, pika 1.d]</p> <p>[KolegjiUniversitarBedër:https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/programi-profesional- programim- ne-web--14/616/691]</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 12 Plani Strategjik 2018-2023]</p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se programi studimit Diplomë Profesionale “Programim në Web” është hartuar në përputhje me qëllimet, misionin dhe fushën e veprimtarisë së Kolegjit Universitar Bedër. Në planin strategjik cilësohe se Misioni i Kolegjit Universitar Bedër është përgatitja e individëve të kualifikuar, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale, si dhe mbështetja e kërkimit shkencor me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve, që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe mbarë shoqërisë. Në Statutin e Kolegjit Universitar Bedër cilësohet se:</p> <p>Statutin e Kolegjit Universitar Bedër në të gjithë veprimtarinë e tij, ka për qëllim: a. të përgatisë specialistë të lartë me dije të nivelit bashkëkohor në fushën e shkencave islame, jurisprudencës, shkencave të komunikimit, ekonomisë, biznesit, teknologjisë së informacionit, shkencave kompjuterike, shkencave të edukimit, gjuhëve të huaja, duke zhvilluar programe studimi në</p>

	<p>profilat përkatëse në auditore etj.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 10 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, neni 4]</i> <i>[Dok DVV Evidenca nr. 12 Plani Strategjik 2018-2023, Misioni & Profili i Kolegjit Universitar "Bedër"]</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike janë hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e KU "Bedër" dhe janë në përputhje të plotë me misionin dhe fushën e veprimtarisë së këtij institucioni. Kjo është e percaktuar në misionin e departamentit, ku theksohet se misioni i departamentit për këtë program është përgatitja e individëve me njohuri të thella në fushën e teknologjisë së informacionit dhe kompjuterizimit, si dhe zhvillimi i të menduarit kritik për të kuptuar dhe për t'u përshtatur në botën që zhvillohet me shpejtësi.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 10 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër]</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacioneve institucioni ka realizuar studimin për tregun e punës përpara hapjes së programit. Në këtë studim përfshihet informacion mbi numrin e kërkesave të maturanteve për programet e TIK, programet e ngjashme të ofruara në institucionet e arsimit të lartë në vend, mundësitë e punësimit të studenteve në tregun rajonal, kombëtar e nderkombëtar, kërkesat e punedhënësve, etj. Nga takimi i zhvilluar në institucion me stafin akademik u konstatua se Departamenti i Shkencave Kompjuterike ka të angazhuar staf akademik specialishtë të fushës në Programimin në Web duke i lidhur më shumë studentët me kërkesat e tregut e të punës.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 13 Studimi tregu i programit me karakter profesional 'Programim në Web']</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Nga vlerësimi i dokumentacionit dhe vizitave në institucion, GVJ konstaton se KU Bedër ka përvojën, kapacitetet si në infrastrukturë dhe struktura ndihmëse dhe burimet e duhura në fushën e programimit në Web.</p> <p>Personeli akademik i Departamentit të Shkencave Kompjuterike i cili është angazhuar në programin e studimit është i kualifikuar, me përvojë në këtë fushë studimore dhe aplikative. Gjithashtu në këtë program janë të angazhuar specialist të fushës së IT-së dhe programimit në web, si lektorë me kohë të pjesshme apo asistent në lëndë të caktuara, gjë që mundëson rritjen e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 49 CV-të e stafit akademik].</i></p>
<p>Kriteri 6. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të</p>	<p>Njësia kryesore, Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit, nëpërmjet Departamentit të Shkencave Kompjuterike ofron programe studimi në fushën e teknologjisë dhe shkencave kompjuterike që prej 5 vitesh. Kjo njësi kryesore ofron gjithashtu programe të tjera në fushën e teknologjisë dhe shkencave kompjuterike: përkatesisht "Bachelor" në "Shkenca Kompjuterike", "Bachelor" në "TIK" dhe " Master në Shkenca Kompjuterike".</p> <p>GVJ konstaton se aktiviteti mësimor-kërkimor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike është në përputhje me një nga fushat akademike e kërkimore të Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit, fushën e shkencave kompjuterike.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 28 Organigrama e Kolegjit Universitar Bedër]</i></p>

studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	[Dok DVV Evidenca nr. 20 Organigrama e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit] [Dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit te studimit me karakter profesional ne 'Programim ne Web'] [Faqe web: https://www.beder.edu.al/sh/content/default/programet-e-studimit-5-2/5/380].			
Konkluzione	GVJ konstaton se programi i studimit Profesional "Programim në Web", i ofruar nga nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike në Kolegji Universitar Bedër, synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Programet e studimit në Departamentin e Shkencave Kompjuterike janë në përputhje të plotë me misionin dhe fushën e veprimtarisë së këtij institucioni.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Ndarja e detyrave mes njësive e personelit përcaktohet nga institucioni në rregulloren e tij Themelore dhe atë të Organizimit Akademik. Nga vlerësimi rezulton se Departamenti i Shkencave Kompjuterike menaxhon dhe drejton me efektivitet programin Profesional 2-vjeçar në Programim në Web. Në fillim të vitit akademik njesia bazë dërgon në njesinë kryesor për miratim planin e aktiviteteve për fillimin e vitit akademik. Ky program ka një ka një kohëzgjatje 2-vjeçare dhe në total përmban 120 kredite. [Dok DVV Evidenca nr. 15 Rregullorja Themelore] [Dok DVV Evidenca nr. 16 Rregullorja mbi Organizimin Akademik] [Dok DVV Evidenca nr. 21 Vendim i Keshillit te Departamentit per miratimin e planit te aktiviteteve, viti akademik 2021-2022]
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Nga shqyrtimi i dokumentacioneve dhe takimet në institucion, GVJ konstaton se KU "Bedër", ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi ndërinstytucionale me institucione shtetërore dhe IAL brenda vendit, si dhe me kompani dhe zyra, pjesë e komunitetit të biznesit ose tregut të punës. Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit ka zhvilluar aktivitete shkencore, leksione të hapura mobilitet për lëvizshmërinë e personelit akademik dhe të studentëve me institucionet bashkëpunuese. Ndër këto bashkëpunime mund të përmendim universitete në disa vende të Europës, si Itali, Rumani, Kroaci, etj., si edhe me SHBA në kuadër të

	<p>shkëmbimit të studentëve dhe stafit, bashkëorganizimit të aktiviteteve shkencore dhe praktikave studentore: Atom Computers, AKCESK, Big Media Expert, për praktikave profesionale.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 7 Raporti vjetor institucional 2020-2021]</i></p> <p><i>[Dok DVV RVB, Tabela 20]</i></p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 25 Lista e bashkëpunimeve dhe MOU]</i></p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 24 Marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të Erasmus me Universitete në Rumani, Kroaci dhe SHBA;]</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.</p>	<p>GVJ konstaton se, KU Bedër ka marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me disa institucioneve, organizatave dhe bizneseve të ndryshme për kryerjen e praktikave profesionale. Studenteve u ofrohet mundësia të shprehur kërkesat e tyre për realizimin e praktikës. Praktikave studentore zhvillohen për herë të parë këtë vit, në semestrin e katërt për programin Profesional “Programim në Web”. Disa nga institucionet në të cilat u organizuan praktikave profesionale janë ATOM, Communication Progress, Deloitte Albania, AKCESK, Robustek, Codecon VR, Big Media Expert.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 25 Lista e bashkëpunimeve dhe MOU]</i></p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 24 Marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të Erasmus me Universitete në Rumani, Kroaci dhe SHBA]</i></p> <p><i>[Dok DVV RVB, Tabela 5,20;].</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike, përgjegjëse për programin e studimit Profesional 2-vjeçar Programim në Web, kryen raportime vjetor të tij të cilin e dorëzon pranë Rektorit. Në këto raporte paraqitet edhe analiza e bashkëpunimit me aktorët e jashtëm në kuadër të procesit mësimor dhe formues. Bashkëpunimi me disa institucione publike dhe private mundëson edhe realizimin e praktikave profesionale. Ky është vit i parë i zhvillimit të praktikave profesionale dhe ende nuk ka të dhëna analitike nga përfitimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit. Bashkëpunimi me aktorët e jashtëm, në kuadër të procesit mësimor dhe formues, ka bërë të mundur realizimin e workshopeve, praktika profesionale dhe intershipeve të ndryshme si kompanive të ndryshme.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 7 Raporti vjetor institucional 2020-2021]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndërmerri iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>Nga takimet në institucion dhe shqyrtimi i dokumentacioneve, GVJ konstaton se KU "Bedër", ka lidhur marrëveshje në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve me kompani të fushës së IT dhe programimit p.sh rasti i Atom Computers. Studentët kanë mundësi të zhvillojnë praktikave mësimore por edhe të punësohen në këto kompani. <i>[Dok DVV Evidenca nr. 25 Lista e bashkëpunimeve dhe MOU]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se KU "Bedër" siguron marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të jashtëm, me disa institucione publike dhe private në kuadër</p>

	të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisit profesional, dhe mobilitetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në KU “Bedër” funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshme të Cilësisë (NJSBC). NJSBC monitoron dhe koordinon aktivitete të cilat lidhen me procesin mësimor dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies në programin Profesional “Programim në Web”. NJSBC bashkë me dy komisionet e përhershme, përkatësisht Komisioni i përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin si edhe Komisioni i përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe programeve të studimit, bashkërendojnë punën me njësitë e tjera kryesore për të përpiluar raporte vlerësimi për stafin akademik dhe pyetësorë për studentet si burime informacioni. Këto raporte shërbejnë për të hartuar një raport përfundimtar i cili i dorëzohet instancave drejtuese duke garantuar po ashtu edhe elemente të konfidencialitetit. Në baze të raportit përfundimtar, merren edhe vendimet përkatëse të cilat synojnë përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe përmbushjen e standardeve të përcaktuara nga MAS.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 10 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër, kreu VIII]</i></p> <p><i>[Evidenca nr. 44: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC] [Evidenca nr. 6 Vendim senati për miratimin e ngritjes së komisioneve të përhershme]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>KU “Bedër” me anë të NJSBC siguron një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. NJSBC funksionon si njësi që varet direkt nga rektori dhe ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Ajo përbëhet nga 5 anëtarë ku tre janë staf akademik, një student dhe një ekspert i jashtëm. Puna e NJSBC orientohet nga plani strategjik i institucionit në drejtim të zbatimit të politikave dhe procedurave bashkëkohore bazuar në Standardet Kombëtare dhe Evropiane të Sigurimit të Cilësisë. Kjo njësi në bashkëpunim me komisionet e përhershme, garanton sigurimin e cilësisë nëpërmjet vëzhgimeve, pyetësorëve dhe studimeve të vazhdueshme të cilat dokumentohen dhe përdoren në procesin e vlerësimit të procesit mesimor. Rezultatet e gjetjeve së bashku me propozimet përkatëse i</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 10

	<p>paraqiten senatit akademik të institucionit.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 10 Statuti i Kolegjit Universitar Beder, kreu VIII] [Dok DVV RVB, Tabela 24]</i></p> <p><i>[Evidenca nr. 44: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC] [Evidenca nr. 12 Plani Strategjik 2018-2023]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë garantohet nëpërmjet procesit të akreditimit si institucional ashtu edhe të programeve që institucioni ofron. KU Bedër ka kaluar tre akreditime institucionale duke fituar një eksperiencë të mirë në këtë drejtim. Nga takimet në institucion GJV kostaton se NJSBC është e orientuar drejt përdorimit të praktikave më të mira për sigurimin e cilësisë duke e shtrirë vlerësimin në disa drejtime si atë të mbarëvajtjes së procesit të mësimdhënies, literaturës së përdorur, teknikave të mësimdhënies dhe përmbushjen e objektivave të programeve mësimore. Me anë të anketimit dhe vlerësimit merren të dhëna për: stafit akademik, stafin akademik ndaj institucionit, stafin administrativ ndaj institucionit, vlerësimi i studentit ndaj institucionit dhe vlerësimi i studentit për stafin akademik. Këto vlerësime përdoren në raportet e vlerësimit apo vetëvlerësimit me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 41: Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve]</i></p> <p><i>[Evidenca nr. 44: Rregullorja per funksionimin dhe organizimin e NJSBC]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.</p>	<p>KU Bedër ndjek në mënyrë periodike procedura që synojnë të garantojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në programin Profesionale “Programim në Web”. Rezultatet dhe propozimet përkatëse të pyetsorëve të studentëve në fund të çdo semestri, raportohen para Senatit Akademik.</p> <p>Çdo fundviti akademik, raporte e ndërmjetme dhe ato vjetore në nivel të NJSBC dhe institucional dergohen ne rektorat. Një rëndësi e vecantë në këto raporte ka dhe pasqyrimi i gjendjes, arritjeve, dobësive dhe masave rregullatore institucionale. Kjo reflektohet dhe në Planin Strategjik i cili synon zhvillimin në tri fusha kryesore: mësimdhënie, kërkim shkencor dhe kontribut në shoqëri.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 10 Statuti i Kolegjit Universitar Beder]</i></p> <p><i>[Evidenca nr. 44: Rregullorja per funksionimin dhe organizimin e NJSBC] [Evidenca nr. 7 Raporti vjetor institucional 2020-2021; Evidenca nr. 9 Plan veprimi per vleresimin institucional te kerkimit shkencor]</i></p> <p><i>[Evidenca nr. 12 Plani Strategjik 2018-2023]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GJV konstaton se në KU “Bedër” funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshme të Cilësisë (NJSBC). NJSBC monitoron dhe koordinon aktivitetet të cilat lidhen me procesin mësimor dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies në programin Profesional “Programim në Web”.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit me karakter profesional në "Programim në Web", është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka një kohëzgjatje 2 vite dhe në total 120 kredite. Plani mesimor i këtij programi është i organizuar në lëndë bazë të detyrueshme (13%), lëndë karakterizuese (55%), lëndë ndërdisiplinore (12%), lëndë plotësuese (15%) dhe detyrime përmbyllese (5%).</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit te studimit me karakter profesional ne "Programim ne Web"]</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.</p>	<p>GVJ konstaton se programi profesional në "Programim në Web", nëpërmjet moduleve dhe lëndëve të ofruara krijon mundësinë e formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh. Studimi i Tregut evidentoi disa specialitete për të cilat formohen studentët e këtij programi. Objektivi i përgjithshëm i programit është të përgatitë specialistë në zbatimin e metodologjive në fushën e Programim në Web dhe bazë të dhënash. Studentët kuptojnë parimet e ndjekura për të krijuar një faqe dhe aplikacion webi efikas, duke përfshirë njohuri të thelluara mbi strukturën e informacionit. Ky program trajton në mënyrë të përmbledhur dhe praktike njohuritë dhe metodat mbi gjuhët HTML, CSS, JavaScript, programim në .Net (C#), Python, Ruby on Rail, si edhe integrimin e tyre reciprok.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit te studimit me karakter profesional ne 'Programim ne Web']</i></p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 13 Studimi tregu i programit me karakter profesional 'Programim ne Web']</i></p> <p><i>[Faqe web: https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/programi-profesional-programim-ne-web--2-10/616/691]</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të</p>	<p>Programi i studimit 2-vjeçar me karakter profesional në "Programim në Web" ofron njohuri për studentë që janë të interesuar t'a ndërtojnë karrierën e tyre profesionale në ndërtimit e faqeve dhe aplikacioneve të bazuara në Web, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. Në këtë program trajtohen gjuhë për zhvillim e programeve në Web, gjuhë për zhvillimin në Web në Server, Databasë-at server, platforma të dizenjimit dhe programimit në CMS si dhe mjetet kryesore të formimit</p>

<p>programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>të aplikacioneve të bazuara në Web. Ky program profesional thellohet në si në aspektet konceptuale ashtu edhe ato praktike të Programimit në Web.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit te studimit me karakter profesional ne 'Programim ne Web'Faqe web: https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/programi-profesional-programim-ne-web--2-10/616/691]</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblyëse.</p>	<p>Programi Proefesional “Programim në Web” ka një kohëzgjatje studimesh 2 vite akademike.</p> <p>Nga shqyrtimi i rregullores së programit, planit mësimor dhe syllabuseve, GVJ konstaton se programi ka të përcaktuar qartësisht ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët. Ky program përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 21 lëndë • 1 lëndë me zgjedhje • Praktikë Profesionale (4 kredite) • Projekt Perfundimtar (6 kredite). <p>Shpërndarja e krediteve në 4 semestra rezulton e shprehur qartë. Ky program rezulton me 30 kredite për semestër, 60 kredite në një vit të plotë akademik dhe 120 kredite në total.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit te studimit me karakter profesional ne 'Programim ne Web']</i></p> <p><i>[Evidenca nr. 30 Syllabuset e programit]</i></p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Forma e organizimit të programit të studimit me karakter profesional është e saktësuar në Statutin e KU Bedër në Neni 64 të tij dhe specifikisht në rregulloren e programit të studimit. Pranimi i studentëve në programin Profesional “Programim në Web” në KU "Beder" realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të MAS. KU "Beder" mbështet financimin e studentëve me status të veçantë. Kategoritë e bursave janë sipas meritës dhe sipas mbështetjes sociale.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 10 Statuti i Kolegjit Universitar Beder]</i></p> <p><i>[Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit te studimit me karakter profesional ne 'Programim ne Web']</i></p> <p><i>[Evidenca nr. 13 Studimi tregu i programit me karakter profesional 'Programim ne Web']</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel,</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit me karakter profesional në "Programim ne Web" është bashkëkohore dhe i kushton rëndësi si zhvillimit të njohurive teorike të studentëve ashtu edhe aftësimit praktik. Nga studimi i tergut për hapjen e programit të studimit programi profesional “Programim në Web” është i pari në rajon. Ky program orfon përafërsisht deri në masën 30% të krediteve një</p>

së paku 70 për qind.	kurrikul specifike të profilit të ndërtimit të faqeve Web dhe ndërtimit të aplikacioneve me bazë Web-in. <i>[Dok DVV Evidenca 14 Rregullorja e programit të studimit me karakter profesional në 'Programim në Web']</i> <i>[Evidenca nr. 13 Studimi tregu i programit me karakter profesional 'Programim në Web']</i>			
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	KU Bedër është në proces kodifikimin bazuar në udhezimin e MAS datë 15.11.2022. Forma dhe suplementi i diplomës së programit të studimit me karakter profesional në "Programim në Web" është miratura në 2 Mars 2023 dhe është përcjell në QSHA në 13 Mars 2023. <i>[Dok Shtese Evidenca 5 Koorespondenca me QSHA]</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia kryesore 'Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit' është riorganizuar me urdhrin e MASR Urdher nr. 200, date 3.7.2020, 'Per riorganizimin e njesive kryesore te Kolegjit Universitar 'Beder'. Departamenti i Shkencave Kompjuterike si njësi bazë në dhe Fakultetin e Teknologjisë dhe Biznesit si njësi kryesore disponojnë një strukturim organizativ dhe të përshtatshëm për nevojat e programit të studimit. Institucioni ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik, për herë të parë në vitin 2013, riakreditimi në vitin 2017 dhe në datë 16.12.2021 u riakreditua KU Beder deri në vitin 2026. Të gjitha programet e ofruara nga njesite bazë janë të akredituara, në proces akreditimi ose brenda afateve për akreditim. <i>[Dok DVV Evidenca nr. 5 Urdher nr. 200, date 03.07.2020 ' Per riorganizimin e njesive kryesore te Kolegjit Universitar 'Beder']</i> <i>[Evidenca nr. 2 Urdher nr. 223, date 04.06.2013 'Per Akreditimin institucional dhe te programeve te studimit']</i> <i>[Dok DVV Evidenca nr. 3 Vendim i BA Nr. 101, datë 10.11.2017 Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë, Kolegji</i>

	<p><i>Universitar Beder]</i></p> <p><i>[DVV Evidenca nr. 4 Vendimi i Bordit te Akreditimit, nr.57, date 16.12.2021 Per akreditimin periodik te IAL Kolegji Universitar Beder]</i></p> <p><i>[Faqe Web: https://ascal.al/sq/bordi-i-akreditimit/vendimet/vendimet-e-mbledhjes-04-mars-2023]</i></p>			
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit për vitin akademik 2021- 2022 ka në përbërje të tij 23 anëtarë personel akademik të brendshëm (PAE), 20 anëtarë personel akademik me kontratë (PAK) dhe 2 personel ndihmës akademik /administrative (PA). Për vitin akademik 2022-2023 ka në përbërje 24 anetare personel akademik efektiv (PAE), dhe 13 anëtarë personel akademik me kontratë (PAK) dhe 3 personel ndihmës akademik /administrative (PA). Në Departamentin e Shkencave Kompjuterike janë: 1 anetar me titullin Prof. Dr., 2 anetarë me graden shkencore "Doktor i Shkencave", 1 anetar në proces doktorature, 5 anetarë me graden "Master i Shkencave" si dhe 2 anetare personel ndihmes akademik,</p> <p><i>[Dok DVV RVB Aneks: Nunri i personelit akademik per çdo njesi baze: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontrate (PAK),titujt/gradat Personeli ndihmes Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA) (Tabelat 1 dhe 2)]</i></p>			
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Në KU Beder koordinatori i programit të studimit zgjidhet me vendim të Këshillit të Departamentit, pranë Departamentin e Shkencave Kompjuterike. Ai caktohet në fillim të çdo viti akademik. Ky koordinator kryen detyrat e ngarkuara dhe merr masat e nevojshme në funksion të mbarevajtjes, zhvillimit të programit dhe praktikave profesionale, në përputhje me objektivat e programit të studimit.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 29 Vendimi per caktimin e Koordinatorit te Programeve Bachelor, viti akademik 2022-2023]</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Departamenti i Shkencave Kompjuterike si njësi bazë në dhe Fakultetin e Teknologjisë dhe Biznesit si njësi kryesore disponojnë një strukturim organizativ dhe të përshtatshëm për nevojat e programit të studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se Departamenti i Teknologjisë dhe Biznesit disponon dhe ka vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si: Rregulloren dhe programin mësimor; syllabuset; Ngarkesën Mësimore, etj.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit te studimit me karakter profesional ne 'Programim ne Web']</i></p> <p><i>[Dok Evidenca nr. 30 Syllabuset e programit.]</i></p> <p><i>[Ngarkesa totale e personelit akademik të programit me karakter profesional 'Programim në Web', Viti akademik 2022-2023, Tabela 4]</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/ moduleve në kredite, orët në auditor/ jashtë auditorit.</p>	<p>GVJ konstaton se plani mësimor përmban informacionet për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Frekuentimi dhe ndjekja e programit përcaktohen në rregulloren e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve përcaktohet te syllabuset e lëndëve.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit te studimit me karakter profesional ne 'Programim ne Web']</i></p> <p><i>[Dok Evidenca nr. 30 Syllabuset e programit.]</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se Rregullorja e programit të studimit me karakter profesional “Programim në Web” dhe rregullorja e transferimit të studimeve përmban të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me pranimin, regjistrimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. GVJ citon nga rregulloren e programit: Kriteret e pranimit të studentëve miratohen nga Senati Akademik brenda periudhës së përcaktuar nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe dërgohen në institucionet e MASR, QSHA dhe RASH. Kriteret publikohen në portalin U-Albania i cili është i aksesueshëm nga institucionet.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit te studimit me karakter profesional ne 'Programim ne Web', Neni 5; Evidenca nr. 32 Rregullorja e Transferimit te Studimeve],</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultojnë se syllabuset e lëndëve janë të paraqitura në strukturë sipas VKM nr. 41, dt. 24. 01. 2018. Programet e lëndëve përmbajnë të gjitha informacionet, sipas formatit të miratuar nga VKM nr. 41, si: titulli i lëndës, tipologjia e lëndës sipas klasifikimeve dhe llojin (e detyrueshme apo me zgjedhje), përmbledhja dhe rezultatet e të nxënësve; konceptet themelore; numri i orëve të leksioneve, seminareve, punëve të laboratorit, praktikave të ndryshme, konceptet kryesore dhe tematikat që do të trajtohen, formatet e frekuentimit dhe të kontrollit të dijeve dhe mënyrat e vlerësimit dhe pikëzimit të studentit etj.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 30 Syllabuset e programit; Shembull syllabusi CMP 230 Programim i avnacuuar ne Web].</i></p>

<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.</p>	<p>Sipas RVB, stafit akademik i kërkohet të përditësojë syllabuset në fillim të vitit akademik. Praktika të propozimeve për ndryshime në kurrikulën e programit të studimit nga njësinë bazë nuk ka.</p> <p><i>[Dok DVV RVB]</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konsataton se programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.4</p>	
<p>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se emërtimi i programit të studimit me karakter profesional “Programim në Web” është në përputhje me fushën akademike të tij. Shpërndarja e lëndëve dhe përmbajtja e veprimtarive mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike. Praktikant në institucione të ndryshme ju mundësojnë studentëve aftësimin dhe në disa raste punësimin e studentëve.</p> <p><i>[Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit të studimit me karakter profesional në 'Programim në Web']</i></p> <p><i>[Takimet në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet në institucion, GVJ konstaton se mundësohet arritja e objektivave formuese të programit të studimit me karakter profesional “Programim në Web” dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional. Programi 2-vjeçar ka një strukturë të qartë dhe të mirëorganizuar të lëndëve. Ky program përmban 22 lëndë, praktikë profesionale dhe projekt përfundimtar. Organizimi i lëndëve bëhet në 5 disiplina në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Plani mësimor realizohet në 4 semestra me nga 30 kredite. Për një kredit realizohen 25 orë mësimore.</p> <p>Në çdo semestër 750 orë mësimore. Ngarkesa mësimore në auditore në semestrin e parë është 15 ore/javë, në semestrin e dytë dhe të tretë është 13 ore/ javë ndërsa në semestrin fundit është 9 ore/ javë. Programi mësimor është hartuar me objektiva të qarta dhe pritshmëri për studentët në fund të diplomimit. Çdo syllabus është hartuar për të dhënë një konceptim të organizimit të lëndës duke pasqyruar edhe</p>

	<p>objektivat dhe rezultatet e pritshme për studentët. Programi mësimor monitorohet nga departamenti i Shkencave Kompjuterike dhe njësitë si NJSBC, të cilët garantojnë mbarëvajtjen e tij dhe cilësinë.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit të studimit me karakter profesional në 'Programim në Web']</i></p> <p><i>[Evidenca nr. 30 Syllabuset e programit; Takimet në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/ aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësisimit në praktikë/ punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Programit i studimit me karakter profesional “Programim në Web” është hartuar në bazë të komponenteve të specifikuar në VKM nr. 41, dt. 24. 01. 2018. Kreditet sipas lëndëve janë të ndara në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lëndët bazë (Simbolika A 10%-15%) përbejnë 13% të totalit të krediteve të programit të studimit; • Lëndët karakterizuese (Simbolika B 45%-55%) përbejnë 55% të totalit të krediteve të programit të studimit; • Lëndët nderdisiplinore/ integruese (Simbolika C 5%-15%) përbejnë 12% të totalit të krediteve të programit të studimit; • Lëndët plotësuesë (Simbolika D 10%-15%) përbejnë 15% të totalit të krediteve të programit të studimit; • Lëndët plotësuesë dhe Detyrime permbyllyse (Simbolika E 3%-5%) përbejnë 5% të totalit të krediteve të programit të studimit. <p>GVJ konstaton se lëndët janë në përputhje me profilin e programit dhe, rrjedhimisht, të domosdoshme për formimin e specialistëve në fushën e programimit në Web. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit me karakter profesional “Programim në Web”. Raporti teori/ praktik është kryesisht 50 % / 50%. Me kalimin e semestrave pesha e ngarkesës mësimore praktike rritet.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit të studimit me karakter profesional në 'Programim në Web']</i></p> <p><i>[Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E), Tabela 9]</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se plani mësimor, kreditet sipas veprimtarive formuese si dhe syllabuset e lëndëve janë ndërtuar në mënyrë të tillë që ju mundësojnë studentëve formimin profesional të tyre në përputhje me tregun e punës. Raporti i lëndëve që studentët zhvillojnë në këtë program studimi ju krijonë mundësinë për mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> <p>GVJ konstaton se në planin mësimor të paraqitur nga GVB, në vitin akademik 2022-2023 rezultojnë 1506 orë mësimore në auditor, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 750 orë leksione - 105 orë seminare

	<ul style="list-style-type: none"> - 435 orë ushtrime dhe laboratorë - 60 kontrollit të vazhdueshem dhe seanca të praktikave profesionale - 39 orë praktikë profesionale - 117 Diploma/Provim Formimi - Totali 1506 orë mësimore në auditor <p>Raporti teori/ praktike është 50%/ 50%.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit të studimit me karakter profesional në 'Programin në Web']</i></p> <p><i>[Evidenca nr. 30 Syllabuset e programit]</i></p> <p><i>[Dok RVB Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuse (A-E), Tabela 9, Mesimi në auditor dhe terren Tabela 13]</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.</p>	<p>Nga takimet me stafin akademik dhe GVJ konstatoi se pedagogët e lëndëve në fillim të çdo viti akademik përditësojnë syllabuset në përputhje me zhvillimet teknologjike duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse. Sipas RVB, syllabuset ngarkohen në fillim të çdo semestri vitit akademik. Pedagogu i lëndës ngarkon në sistemin informatik institucional Beder Information System (BIS) programin e lëndës që jep, bashkë me përditësimet e nevojshme. Programi i lëndës dorëzohet edhe pranë koordinatorit të departamentit.</p> <p><i>GVJ rekomandon që në syllabuset e lëndëve të vendoset titullari i lëndës.</i></p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 30 Syllabuset e programit]</i></p> <p><i>[Dok DVV RVB]</i></p>
<p>Kriteri 6. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>KU Bedër ka marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me disa institucione, organizata dhe biznese të ndryshme për kryerjen e praktikave profesionale. GVJ konstaton se janë organizuar takime të studentëve me bashkëpunëtorë dhe partnerë të ndryshëm nga tregu i punës duke i orientuar rreth kërkesave dhe pritshmërive të punëdhënësve eventuale të mundshëm. Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, u konstatua një bashkëpunim shumë i ngushtë me bashkëpunëtorë dhe partnerë të ndryshëm nga tregu i punës të cilët ishin ftuar të jepnin mësim.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 25 Lista e bashkëpunimeve dhe MOU]</i></p> <p><i>[Kolegji Universitar Bedër (beder.edu.al)</i> <i>https://www.beder.edu.al/sh/news/activities/java-boterore-e-sipermarrjes-14/1782;</i> <i>https://www.beder.edu.al/sh/news/activities/albania-code-camp-2022/1757; https://cmp.beder.edu.al/sh/news/activities/internship-me-teme-programim-ne-c/1758]</i></p> <p><i>[Vizita në Institucion: Takimi me stafin akademik]</i></p>

<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.</p>	<p>Nga shqyrtimi dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se, programi i studimit duke kombinuar teorinë me praktikën siguron aftësi dhe kompetenca në fushën e Programimit në Web në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës dhe në përputhje me nivelin 5 të KSHK. Përfundimi me sukses i këtij programi studimi ju mundëson studentëve përgatitje të kualifikuar duke përdorur teknologjitë më bashkëkohore të internetit dhe Web-it.</p> <p>Përmbajtja e programit me karakter profesional “Programim në Web” granton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara në fushën e programimit në Web, duke ofruar lëndë si Inxhinieri në Web, Programim i Orientuar në Objekte, Siguri të Dhënash, Programim në Web; Teknologjia .NET, Bazat e të Dhënave, Programim Mobile, Testim Software-i dhe Sigurim i Cilësisë, etj.</p> <p>[Dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit të studimit me karakter profesional në 'Programim në Web']</p> <p>[Evidenca nr. 13 Studimi tregu i programit me karakter profesional 'Programim në Web']</p> <p>[RVB Plani mësimor Tabela 9]</p> <p>[Faqe Web: https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/programi-profesional-programim-ne-web--2-10/616/691]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës për Programues në Web.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në institucion, konstatoi se nga Zyra e Karrierës në KU Bedër janë organizuar takime të studentëve me bashkëpunëtorë dhe partnerë të ndryshëm nga tregu i punës duke i orientuar rreth kërkesave dhe pritshmërive të punëdhënësve eventuale të mundshëm.</p> <p>Zyra e planifikimit të karrierës organizon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Takime prezantuese mes studentëve të diplomuar dhe institucioneve të ndryshme në sektorë të ndryshëm; • Informim të studentëve me profesionet përkatëse;

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 21

<p>institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Jetën e punës; • Mundësitë e karrierës; • Vendosijen e lidhjeve mes institucioneve që kërkojnë persona për të punësuar dhe studentëve; • Informon studentët nëpërmjet organizimit të seminareve, rreth teknikave të kërkimit të punës, të shkrimit të CV-së dhe kalimit me sukses të intervistës paraprake. <p><i>[Vizita në Institucion: Takimi me stafin akademik]</i></p> <p><i>[Faqe web: https://www.beder.edu.al/sh/content/default/zyra-e-planifikimit-te-karrieres-14-0/424/426]</i></p>								
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>KU Beder ka ngritur disa organe siç janë: Dekani i studenteve dhe presidenti i këshillit studentor të cilët bashkëpunojnë me instancat drejtuese për të adresuar problematikat dhe menaxhimin e marrëdhënieve me studentet. Qellimi i këtyre organeve është që të garantohet përfshirja e studenteve në organe vendimmarrëse në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Studentet kanë përfaqësues në senatin akademik, në NJSBC si edhe në Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standarteve dhe Cilësisë. Studentët përcjellin mendimin dhe vlerësimin: mbi programin dhe për çdo lëndë në perfundim të semestrit. Studentë të diplomuar nuk ka sepse ky program studimi akreditohet për herë të parë.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 10: Statuti i KU Beder, Neni 52]</i></p> <p><i>[Evidenca nr. 45 Anketa e studentit ndaj lendes]</i></p>								
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë dhe institucione publike e private.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike si njësi përgjegjëse për programin me karakter profesional “Programim në Web” përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh si dhe institucione publike e private. Sipas RVB, syllabuset me ndryshimet dhe përmirësimet kryhen në fillim të çdo semestri të vitit akademik. Për tu përshtatur me zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme bëhen trajnime për stafin akademik.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 38 Lista e trajnimeve për stafin]</i></p> <p><i>[Dok DVV RVB; Minuta]</i></p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se KU Beder përmes aktivizimit të studentëve në vendimmarrje, anketimit të tyre, trajnimeve të stafit dhe studenteve, si dhe bashkëpunimeve, nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="576 1697 794 1794">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="794 1697 1002 1794">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1002 1697 1177 1794">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1177 1697 1361 1794">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion GVJ konstaton se personeli akademik i programit me karakter profesional “Programim në Web”, zhvillon format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive përmes leksioneve, seminareve, punëve laboratorike, detyrave të kursit, praktikave profesionale. Syllabuset e lëndëve miratohen në departament.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit të studimit me karakter profesional në 'Programim në Web']</i></p> <p><i>[Evidenca nr. 30 Syllabuset e programit]</i></p> <p><i>[Vizita në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se personeli akademik i programit me karakter profesional “Programim në Web”, merr në konsideratë nevojat e studentëve dhe bashkëpunon me ta për të ofruar një eksperiencë mësimdhënie-mësimnxënie sa më të mirë. Leksionet e hapura, vizitat në institucione të ndryshme, aktivizimi në konkurse, etj. janë disa nga aktivitetet e realizuara.</p> <p><i>[Faqe Web: https://www.beder.edu.al/sh/news/activities/]</i></p> <p><i>[Vizita në Institucion: Takimi me studentët; Takimi me stafin Akademik]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Nga dokumentacioni i dorëzuar dhe takimet me stafin në institucion GVJ konstaton se KU Bedër angazhohet për përmirësimin e kompetencave didaktike të personelit të tij akademik dhe ndihmës akademik. Ai zhvillon trajnime me qëllim përmirësimin e kompetencave didaktike. GVJ pas vizitës në institucion konstaton se mjediset ku zhvillohet mësimi i programit mundësojnë për personelin akademik përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike. Mjediset ku zhvillohet mësimi i programit kanë rrjet kompjuterik; akses për internet; tabela inteligjente; kompjutera dhe pajisje multimediale.</p>

	<p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 38 Lista e trajnimeve per stafin]</i></p> <p><i>[Vizitat në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik te student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga analizimi i CV-ve të personelit akademik, GVJ konstaton se personeli akademik i programit me karakter profesional “Programim në Web”, ka përgatitje dhe kompetenca profesionale në mësimdhënie dhe në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Pjesë e personelit akademik të programit të studimit janë edhe individë ekspert të fushës, me njohuri që lidhen dhe me kurrikulën e programit. Eksperienca e tyre u shërben për të demonstruar në auditor raste reale të lidhura me fushën e programimit në Web.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 49 CV te stafit akademik]</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Nga takimet me grupin e GVB personeli akademik në KU Bedër plotëson formularin e anketave vetëvlerësuese që kontrollohet nga përgjegjësi i departamentit përkatës. Gjithashtu rezultatet e anketimeve dhe vlerësimeve të anketës vlerësuese të studentit për stafin akademik, ku përfshihen dhe format dhe metodat e mësimdhënies, i komunikohen çdo pedagogu në mënyrë individuale. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se personeli akademik i programit me karakter profesional “Programim në Web” merr në konsideratë kërkesat e studentëve për të ofruar një eksperiencë mësimdhënie-mësimnxënie sa më të mirë. Stafi akademik përditëson syllabuset në fillim të vitit akademik ku reflekton dhe përmirësimin e formave e metodave të mësimdhënies.</p> <p><i>[Dok DVV Evidenca nr. 42 Formular i vleresimit per stafin akademik]</i></p> <p><i>[Vizita në institucion: Takim me studentët; Stafin Akademik të Programit;]</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të</p>	<p>Në KU Bedër është funksionale Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Kjo njësi promovonë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/ bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Në rregulloren e NJSBC-së janë të përcaktuara menyren e organizimit dhe detyrat që kanë njësitë në nivel fakulteti dhe departamenti. Me anë të anketimeve të kryera nga studentet dhe vlerësimit nga titullari i njesisë, personeli akademik ka mundësi të përmirësojë cilësinë.</p> <p>NJSBC është e orientuar drejt përdorimit të praktikave më të mira për sigurimin e cilësisë duke e shtrirë vlerësimin në disa drejtime si atë të mbarëvajtjes së procesit të mësimdhënies, literaturës së përdorur, teknikave të mësimdhënies dhe përbushjen e objektivave të programit SHK. Po ashtu sigurimi i jashtëm i cilësisë garantohej nëpërmjet procesit të akreditimit qoftë institucional ose të programeve</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 24

mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	që institucioni ofron. KU Beder ka kaluar disa akreditime institucionale duke fituar nje eksperience të mirë në këtë drejtim. Me anë të anketimit dhe vlerësimit merren të dhëna të cilat përdoren në raportet e vlerësimit apo vetëvlerësimit më qellim të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. <i>[Dok DVV Evidenca nr. 37 Rregullorja per funksionimin dhe organizimin e NJSBC-se]</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se KU Bedër zhvillon format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive përmes leksioneve, seminareve, punëve laboratorike, detyrave të kursit, praktikave profesionale të zhvilluara nga personel akademik kompetent.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, janë të përcaktuara në rregulloren themelore të dhe rregulloren e programit me karakter profesional “Programim në Web”. Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat u bëhen të njohura studentëve nëpërmjet sistemit BIS. <i>[Dok DVV Evidenca nr. 15 Rregullorja Themelore]</i> <i>[Dok DVV Evidenca nr. 14 Rregullorja e programit te studimit me karakter profesional ne 'Programim ne Web']</i> <i>[Dok DVV Evidenca nr. 30 Syllabuset e programit]</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga takimet në institucion, GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve ruhen nga titullari i lëndës/ modulit në sistemin BIS dhe logimit në sistem, ku mund të marrin informacion mbi metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Këto informacione ju komunikohen gjithashtu studentëve në fillim të semestrit nga pedagogu i lëndës. Syllabuset e lëndëve janë gjithashtu të publikuara në Website-in e Kolegjit Universitar Bedër. <i>[Vizita në Institucion]</i> <i>[Faqe web: https://internal.beder.edu.al/curriculum/35/course/6269/version/show]</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i	GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive realizohet në forma dhe

njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.	mënyra të ndryshme. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde janë: Provimi i ndërmjetem, Niveli i pjesëmarrjes ne seminare, Detyra e kursit (projekte), Quize, Provimi perfundimtar. [Dok DVV Evidenca nr. 15: Rregullorja Themelore, neni 100] [Dok DVV Evidenca nr. 30 Syllabuset e programit]			
Konkluzione	GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive realizohet duke u bazuar në rregulloren themelore, rregulloren e programit të studimit dhe në mënyrën e vlersimit të lëndëve të praqitur në syllabuse.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Një pjesë e konsiderueshme e literaturës bazë dhe ndihmëse, në format fizik dhe digjital, ndodhet në bibliotekën e KU “Beder” në hapësirën e dedikuar fushës së teknologjisë së informacionit në mënyrë që studentët të mund të kenë akses të menjëhershëm sipas nevojave. [Lista e shtojcave: Të dhëna për platformat online/ Biblioteka (Tabela 17)]
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka e KU “Beder” ka filluar të japë shërbim që në kohën e themelimit të këtij Institucioni. Eshtë e konceptuar dhe e implementuar në hapësirë me 24 poste leximi, dhe 8 kompjutera në dispozicion. Në bibliotek gjenden 22600 tituj shkencorë, 26000 libra, 166 monografi dhe 48 revista shkencore. GVJ-s j’u vu në dispozicion programi që information kërkimin automatic të çdo artikulli. Biblioteka është e abonuar ne revista shkencore on-line si Jstore që lejon përdorimin e më shumë se 12 milion artkuj të revistave shkencore. Biblioteka e KU “Beder” mundeson komunikimin dhe në Book Academic Collection [Evidenca nr.35: Marrëveshja për akses në JTORE] [Vizita GVJ në institucion-Takim në Bibliotekë]
Kriteri 3. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në	Biblioteka e KU “Beder” është e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Ne vërejmë se Biblioteka në përgjithësi mbulon

<p>gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>të gjitha modulet e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit. <i>Rekomandojmë që të pasurohet më tepër me tekste bashkëkohore për lëndët karakterizuese të programit.</i> Biblioteka është në dispozicion të studentëve, për të gjithë kohëzgjatjen e orarit zyrtar të punës së institucionit. Orari i hapjes dhe mbylljes së bibliotekës është 08.30 – 19.00, por në periudhën e provimeve qëndron dhe e hapur edhe gjatë fundjavës. <i>[Vizita GVJ në institucion-Takim në Bibliotekë]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ në vizitën e tij në Bibliotekë, konsaton se studentët dhe pedagogët kanë akses të barabartë e pa pagesë në bibliotekën digjitale online JSTOR, që siguron qasje në më shumë se 12 milion artikuj të revistave akademike, libra dhe burime kryesore në 75 disiplina. Për të lehtësuar kërkimin shkencor është realizuar abonimi me databazë elektronike online. Siç u tha edhe më lart Biblioteka e KU “Beder” mundeson komunikimin dhe në Book Academic Collection. <i>[Vizita GVJ në institucion-Takim në Bibliotekë]</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.</p>	<p>GVJ konsaton se Biblioteka është e pajisur me poste leximi dhe pajisje kompjuterike, për ofrimin dhe aksesimin në bibliotekën digjitale të universitetit dhe të bibliotekave online ndërkombëtare duke përbushur nevojat e studentëve. <i>[Vizita GVJ në institucion-Takim në Bibliotekë]</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka në KU “Beder” është në dispozicion të studentëve, për të gjithë kohëzgjatjen e orarit zyrtar të punës së institucionit. Orari i hapjes dhe mbylljes së bibliotekës është 08.30 – 19.00. Menaxhimi i librave të bibliotekës në KU “Beder” bëhet nëpërmjet platformës digjitale të menaxhimit të librit ku mundësohet menaxhimi i librave sipas kategorive të ndryshme, kontrollimi me lehtësi për lëshimin/ kthimin. Platforma ofron të gjitha opsionet e nevojshme për anëtarët në mënyrë që procesi i kërkesave drejtuar bibliotekës të jetë sa më i lehtë. <i>[Vizita GVJ në institucion-Takim në Bibliotekë]</i> <i>[Faqe web: https://www.beder.edu.al/JSTOR]</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e</p>	<p>Nga takimet, vizitat, që GVJ zhvilloi në institucion, vërehet një frymë bashkëpunimi mes departamenteve e bibliotekës për rritjen e cilësisë së shërbimit të bibliotekës. Për të inkurajuar studentët, për të apasionuarit e librit, apo për të diskutuar rreth sfidave të librit në epokën moderne, librit përballë digjitalizmit, librit dhe teknologjisë, janë marrë fushata sensibilizuese për mbledhjen e librave. Një nismë tjetër që ka kontribuar në pasurimin e bibliotekës ka qënë dhe dhurimi shumë librave nga ambasada Amerikane. <i>[Vizita GVJ në institucion-Takim në Bibliotekë]</i></p>

programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.									
Konkluzione	<i>Programit me karakter profesional “Programim në Web” përmbanë literaturën e nevojshme në mbështetje të mësimdhënies dhe bibliotekën mësimore të pasur me fonde fizike dhe elektronike.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Syllabuset e programit të studimit, kanë në përbërje: leksione, seminare, laboratore dhe praktikat profesionale. KU “Beder” ka marrëveshje me kompani të ndryshme që u siguron studentëve praktika profesionale cilësore, duke filluar që nga viti i parë akademik. Për monitorimin e mbarëvajtjes së praktikave profesionale është hartuar edhe një paketë dokumentacioni me formulare të nevojshëm për t’u plotësuar gjatë ndjekjes së praktikës nga ana e studentëve.</p> <p>Studentët në takim me GVJ pohojnë se për zhvillimin e praktikës ata plotësojnë një formular të miratimit të praktikës, të vlerësimit, dhe një raport mbi zhvillimin e praktikës.</p> <p><i>[Evidenca nr. 34: Formular aplikimi për zhvillimin e praktikës profesionale]</i> <i>[Vizita GVJ në institucion- Takimi me stafin akademik]</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	<p>Studentët në takim me GVJ pohojnë se ato kanë njohuri dhe aftësi për ndertimin dhe mirembajtjen e faqeve web. Stafu kujdeset që të përditësojë kurrikulat dhe syllabuset sipas kërkesave të kohës dhe teknologjive më të fundit.</p> <p><i>[Vizita GVJ në institucion- Takimi me studentët]</i></p>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton	<p>GVJ në takim me stafin akademik në KU “Beder”, mëson se në përfundim të semestrit, lektori i lëndës me anë të vlerësimeve të ndryshme gjatë gjithë semestrit (module, aktivizime në seminare etj.) dhe vlerësimin përfundimtar synon përvetësimin e lëndës nga studenti.</p> <p>Këto trajtohen në diskutim të lirë me studentët, duke nxjerrë dhe konkluzionet e nevojshme për nevojat e përmirësimit të vazhdueshëm të procesit.</p>

studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	<i>[Vizita GVJ në institucion- Takimi me stafin akademik]</i>			
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Për hapjen e këtij program studimi me karakter profesional, "Programim në Web", departamenti është konsultuar me specialistë të fushës, përfaqësues të kompanive dhe bizneseve të ndryshme dhe aktorë të bizneseve. Marrëveshjet dhe memorandumet e mirëkuptimit për praktikat profesionale dëshmojnë për këto bashkëpunime. GVJ konstaton se në kuader të këtyre bashkëpunimeve janë ndërtuar edhe ura ndërlidhëse komunikimi dhe bashkëpunimi me Universitetin e Tor Vergata ne Itali si dhe me universitetin North Dakota në SHBA me fokus shkëmbimin e eksperiencave akademike dhe mbështetjen e shkëmbimeve të lektorëve dhe të studentëve. Këto marrëveshje janë bërë bazë për organizimin e praktikave të studentëve, projekteve të përbashkëta dhe bashkëpunime të tjera. <i>[Evidenca nr. 25: Lista e bashkëpunimeve dhe MOD]</i>			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Nga evidencat dhe pohimet e stafit akademik, departamenti, në fillim të çdo viti akademik, harton një plan aktivitetesh, ndër të cilat bëjnë pjesë edhe leksione e hapura, seminare trajnuese , çorکشope etj. Diskutantët janë staf i brendshëm ose i jashtëm, specialistë të fushës, përfaqësues të kompanive dhe bizneseve të ndryshme etj. Një praktikë shumë e mirë në këto seminare janë dhe seancat demonstruese ku studentëve u shfaqen nga afër aplikime teknologjike, manipulime me pajisje hardëare apo me programe software. <i>[Evidenca nr. 21: Vendim i Keshillit të Departamentit për miratimin e planit të aktivitetëve. viti akademik 2021-2022]</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se programi i studimit Profesional "Programim në Web", i ofruar nga nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike në Kolegji Universitar Bedër, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, kurrikulat dhe syllabuset janë sipas kërkesave të kohës dhe teknologjive më të fundit, duke mundësuar zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek studentët.</i>			
Shkalla e përmbylljes së standardit		Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para	Në Rregulloren Themelore të KU "Beder" punimi i projektit përfundimtar përfshihet si lëndë e semestrit të katërt në programet profesionale. Nga takimi GVJ me studentët pohohet se ata informohen

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 29

<p>realizimit të tyre dhe i bën ato publike.</p>	<p>në vazhdimësi mbi procesin e diplomimit, janë të qartë për detyrimet që duhet të përmbushë ai deri në finalizimin e diplomës. Punimi i diplomimit është i detyrueshëm. GVJ konsatton se procesi i diplomimit nga ana e studentit kryhet në përputhje me programin e studimit.</p> <p><i>[Evidenca nr. 15: Rregullorja Themelore, neni 87. neni 88. neni 89]</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Në KU “Beder” punimi i diplomës nga ana e studentëve mbështetet në 1: manualin për përgatitjen e punimit të diplomës, ku janë të pasqyruara qartë kriteret e vlerësimit si dhe 2: në formularin për vlerësimin e tij. Të gjitha informacionet rreth provimeve finale ose projektit përfundimtar bëhen publike sipas rregullores. Udhëheqësit e projektit përfundimtar janë aktoret kyç në përcjelljen dhe kontrollimin e këtij informacioni.</p> <p><i>[Evidenca nr. 43: Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë].</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në KU “Beder” ngrihet një komision i posaçëm për vlerësimin e projektit përfundimtar që bazohet në shlyerjen e njohurive e dhëna gjatë gjithë vitit akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet.</p> <p><i>[Evidenca nr. 40: Rregulla për organizimin e provimeve]</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Në takim me studentët si dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit GVJ konsatojmë se udhëheqësi i projektit përfundimtar si dhe këshilltari akademik, kanë një rol të rëndësishëm në orientimin dhe përgatitjen e studentëve në prag diplomimi. Mbështetja e udhëheqësit fillon që nga përzgjedhja e temës, tek strukturimi i saj, si dhe përzgjedhja e metodologjisë që do të aplikohet. Këshilltari akademik gjithashtu, në përputhje me udhëzimin për përgatitjen projektit përfundimtar, mbështet studentët edhe në hartimin e konkluzioneve dhe përpilimin e listës përkatëse të literaturës të përdorur si referencë.</p> <p><i>[Vizita GVJ në institucion- Takimi me stafin akademik]</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.</p>	<p>Studentët pohojnë se është udhëheqësi ai që ndihmon studentët edhe për nevoja të veçanta që duhen mundësuar nga institucioni, në kuadër të përgatitjes të punimit të diplomës.</p> <p>Ndihma udhëheqësit akademike, konsiston edhe me asistencën e tyre në analiza, teste, matje etj.</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti</p>	<p>Nga vizita në sekretarinë mësimore vërejmë se, studenti vlerësohet me notë, e cila shfaqet në listën e notave të studentit. Vlerësimi bëhet nga</p>

vlerësohet me notë.	komisioni, përbërja e të cilit miratohet nga departamenti. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë, të cilët janë specialiste të profileve të ngjashme me temën e punimit. [Vizita GVJ në institucion- Takimi në sekretarinë mësimore]								
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me “Çertifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Sipas rregullores studenti pajiset me “Diplomë profesionale” pasi ka kaluar me sukses të gjitha lëndet e parashikuara në programin mesimor dhe ka fituar të gjitha detyrimet. Në programin e studimit me karakter profesional “Programim në Web” ende nuk është diplomuar brezi i parë i studentëve dhe ky është akreditimi i parë për këtë program.								
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Në sekretarinë mësimore ruhen kopje të dokumentacionit të studentit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe jepen në rast se kërkohen. [Evidenca nr. 46: Rregullorja e Arkives, neni 6] [Vizita GVJ në institucion- Takimi në sekretarinë mësimore]								
Konkluzione	GVJ konstaton se në KU Bedër studenti pajiset me “Diplomë profesionale”, sipas rregullores, pasi ka kaluar me sukses të gjitha lëndet e parashikuara në programin mesimor dhe ka fituar të gjitha detyrimet. Në programin e studimit me karakter profesional “Programim në Web” ende nuk është diplomuar brezi i parë i studentëve dhe ky është akreditimi i parë për këtë program.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet përbashkët</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet përbashkët	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet përbashkët	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.6

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Nga dokumentacioni bashkëngjitur dhe vizita e GVJ-së, pohojmë se KU “Beder” ka hartuar udhëzues për mësimdhënien në auditor dhe në distancë ku përfshihen metoda të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, vlerësimit, diplomimit dhe çdo informacion të nevojshëm. [Evidenca nr. 19 Udhezim mbi mesimdhënien ne distance] [Evidenca nr. 26 Udhezim mbi mesimdhënien inovative]
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të	GVJ shqyrtoi anketat e studentëve për vlerësimin e stafit që KU “Beder” organizon në çdo semestër. Gjithashtu shqyrtuam dhe

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 31

<p>monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mesimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>formularin e vetëvlerësimit që stafi plotëson në fund të vitit. Mbi këtë bazë bëhet dhe nga përgjegjesi i departamentit për çdo lektor. Gjithashtu bëhet edhe një vlerësim në rang departamenti dhe fakulteti. Nga vizita në Institucion pohojmë se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe zyra e Vlerësimit të Performancës, në mënyrë të vazhdueshme monitorojnë procesin e mesimdhënies nëpërmjet të dhënave të mbledhura nga stafi akademik, nga njësitë bazë e kryesore, nga studentët, nga stafi administrativ dhe mbi bazën e tyre gjykohe për nevojën për përmirësim të proceseve mesimore por edhe atyre administrative.</p> <p><i>[Evidenca nr. 40: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë]</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mesimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mesimdhënie, është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Kjo realizon anketa të ndryshme, bën shpërndarjen e rezultateve të anketimeve nëpërmjet zyrave përkatëse dhe njësite kryesore, sugjeron ndryshime në program, në burime njerëzore apo infrastrukturë me qëllim rritjen e efektshmërisë dhe cilësisë së programit. GVJ konstaton se këto rezultate të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm bëhen publike.</p> <p>Raportet vjetore të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të KU “Beder” publikohen në faqen e internetit.</p> <p><i>[Evidenca nr. 37: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së, neni 18]</i></p> <p><i>[Vizita GVJ në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mesimdhënies.</p>	<p>Në takimet e GVJ në Institucion, vërejmë që mekanizmat kryesore të vlerësimit për personelin akademik janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Formulari i vetëvlerësimit të stafit akademik i cili kontrollohet nga përgjegjësi i departamentit. - analiza e punës së departamentit. - anketat vlerësuese të studentit për stafin akademik. <p>Këto kanë për qëllim:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Të njohe progresin që ka pasur stafi akademik gjatë vitit. -Të përcaktoje mënyrat nëpërmjet të cilave performanca e tyre mund të përmirësohet. -Të rishikoje zhvillimin e karrierës etj. - Të njohë cilësinë dhe metodat e mesimdhënies së stafit akademik, vlerësimit të dijeve etj. <p>Rezultatet e anketimeve dhe të vlerësimeve i komunikohen çdo pedagogu në zarf të mbyllur.</p> <p>Në bazë të rezultateve, departamentet marrin masa për përmirësimin e mëtejshëm të këtyre metodave të mesimdhënies.</p> <p><i>[Evidenca nr. 54 : Rregullore e anketave dhe vlerësimeve, nenet 3 dhe 14]</i></p> <p><i>[Vizita GVJ në institucion]</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se në KU “Beder” funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). NJSBC monitoron dhe garantton</p>

	<i>cilësinë e mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave inovative për rritjen e cilësisë në programin Profesional “Programim në Web”.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>GVJ bëri vizitë në Zyrën e Burimeve Njerëzore, e cila administron dosjet që përmbajnë dokumentacionin e nevojshëm të personelit efektiv dhe atij me kontratë duke i përditësuar ato vazhdimisht. Në Departamentin e Shkencave Kompjuterike që është përgjegjës për programin Profesional “Programim në Ëeb”, ka një staf prej 23 vetë, nga të cilët, 9 janë Personel Akademik Efektiv, 12 janë Personel Akademik me Kontratë dhe 2 janë Personel Akademik Ndhmës.</p> <p>Në Personelin Akademik Efektiv janë: 1 Prof.Dr, 2 Dr. 6 MSC.</p> <p>Në Personelin Akademik me Kontratë janë: 3 Dr dhe 9 MSC</p> <p>GVJ zgjodhi në mënyrë të rastësishme dosje të pedagogëve të brendëshëm dhe të jashtëm, nga ku konsaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Programim në Web” përmbush kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p><i>[Evidenca nr.49: CV stafit akademik]</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Gjithashu nga kjo vizitë GVJ pohon se personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit profesional 2-vjeçar “Programim në Web” në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Nga 147 orë gjithsej, 117 orë mbulohen nga Personeli Akademik Efektiv, dhe 30 orë mbulohen nga Personeli Akademik me Kontratë, pra rrspektivisht 79.5 % nga PAE dhe 20.5 nga PAK.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Nga shfletimi i dokumentacionit që GVJ bëri në Zyrën e Burimeve Njerëzore konstaton se gjithë personeli akademik si ai efektiv ashtu edhe ai i jashtëm apo administrativ, ka kontrata të rregullta pune.</p> <p>Në këto kontrata janë gjithashtu të gjithë deklaratimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>[Vizita e GVJ në institucion - Takimi në Zyrën e Burimeve Njerëzore]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me</p>	<p>KU “Beder” ndjek me përpikmëri bazën ligjore për rekrutimin e personelit në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, VKM për stafet akademike, Kodi i Punës, aktet nënligjore të MAS. Zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për zbatimin e procedurave të rekrutimit të personelit. GVJ verifikoi se kuadri rregullativ i KU “Beder” përmban procedura transparente të rekrutimit dhe të vlerësimit të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 34

<p>nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>personelit. Në këtë mënyrë KU “Beder” siguron që kandidatët të plotësojnë kushtet dhe të jenë në nivelin e duhur të kualifikimeve në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Gjithashtu kritere e përcaktuara në dokumentin e politikës së rekrutimit, rekrutojnë personel me arritje të larta akademike, me tituj dhe grada shkencore. Kriteret për rekrutimin e tyre lidhen me aftësitë akademike të fushës përkatëse ku do të shërbejë.</p> <p>[Evidenca nr. 10: Statuti KU “Beder”]</p> <p>[Evidenca nr. 15: Rregullorja themelore]</p> <p>[Evidenca nr. 48: Kriteret për vendet vakante]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjedisëve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ vizitoi ambientet dhe laboratorët. Për vetë natyrën e programit të studimit profesional 2-vjeçar “Programim në Web”, një pjesë e mirë e lëndëve zhvillohen në laboratorët e dedikuar për këtë program mësimor. Laboratore e KU “Beder” ka në strukturën e tij personel IT që merret me mirëmbajtjen dhe menaxhimin e kësaj infrastrukture që është në funksion të këtij programi studimi. Janë tre laboratore që përdoren për degët e profilit të IT. <i>GVJ rekomandon të shtohet numri i laboratoreve.</i> Gjithashtu institucioni bashkëpunon me institucione dhe kompani të ndryshme për realizimin e praktikave profesionale nga studentët.</p> <p>[Vizita e GVJ në institucion]</p> <p>[Mjediset e Fakultetit/Njesive baze, Tabela 16]</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ.</p>	<p>GVJ zgjodhi në mënyrë të rastësishme dosje të pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm, nga ku konsaton se Zyra e Burimeve Njerëzore e KU “Beder” ka një bazë të dhënash (dosje personale aplikimi dhe punësimi, formularë vlerësimi, tabela statistikore) për të gjithë personelin, ku për çdo pedagog të programit disponon të dhënat e kualifikimeve të tij/ të saj, kontratat e punës, dokumente që lidhen me vjetërsinë në punë, të dhëna për zhvillimin e vijueshëm profesional.</p> <p>Çdo vit akademik përditësohen CV e pedagogëve, ku pasqyrohen veprimtaritë kërkimore, publikimet dhe konferencat shkencore ku ai/ajo merr pjesë. Departamenti disponon ngarkesën mësimore të secilit pedagog/e për secilin semestër, si dhe oraret mësimore për pedagogët, bashkë me programet lëndore ku pedagogu/ja është titullar/e apo lektor/e e lëndës. Po ashtu, çdo fillim viti dhe semstri përcaktohet ngarkesa mësimore për personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrative.</p> <p>[Evidenca nr. 47: Udhëzime për ngarkesën mësimore]</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion</p>	<p>Studentët në takim me GVJ pohojnë se janë të mbështetur për kryerjen e praktikave profesionale.</p> <p>Fillimisht plotësojnë një formular aplikimi dhe gjatë praktikës ndiqen dhe nga një pedagog i caktuar.</p> <p>KU “Beder” ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me</p>

personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	SHBA, Rumani, Kroaci. Institucioni ka ofruar kryerjen e praktive edhe brenda ambjenteve të KU "Beder", si tek Zyra IT, zyra e mardhënieve me publikun dhe median, portali objektiv.al. Gjithashtu ka marrëveshje dhe me kompani të tjera si Atom Kompjuter për kryerjen e praktikave profesionale apo punimit të diplomës. [Evidenca nr. 34: Formular aplikimi për zhvillimin e praktikës profesionale] [Evidenca nr. 25: Lista e bashkëpunimeve me MOU, shembull Atom Kompjuter]			
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	GVJ në takim me studentët pohon se ata ndjehen të mbështetur në zhvillimin e praktikës profesionale. Në KU Beder" zyra e karrierës mundëson lidhjen e studentëve me tregun e punës si dhe vendin ku kryejnë praktikat profesionale. Procesi i praktikës profesionale nëpër institucionet pritëse zhvillohet sipas udhëzimeve të përcaktuara nga departamenti. Është ambjenti pritës i cili monitoron ecurinë e zhvillimit të kësaj praktike si edhe ndihmon studentin në përmbushjen e raportit përfundimtar që dorëzohet dhe vlerësohet më pas nga stafi akademik. [Vizita në institucion dhe takimi me stafin akademik dhe studentët]			
Konkluzione	GVJ konstaton se në KU "Bedër, personeli akademik efektiv dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet në përputhje me fushën e programit, si të mësimdhënies, ashtu dhe të praktikave të programit të studimit profesional "Programim në Web".			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ vizoi të dy godinat e kampusit universitar "Beder" ku zhvillohet ky program studimi. Hapësirat janë të ndara në 17 klasa leksioni/seminari, 2 laboratorë, 1 salle konferencash, News Room të cilat përdoren për aktivitete mësimdhënie si dhe zyra për stafin. Në godinën A janë përqëndruar kryesisht ambjentet e administratës, holli, biblioteka etj. Në godinën B janë auditoret dhe laboratorët. Gjithashtu News Room është ambjent i shkencave Kompjuterike, përbëhet nga kompjutera dhe tavolina leximi, mund të përdoret edhe si laborator tjetër kompjuterash. Institucioni ka bibliotekën, ambjente të përshtatshme për çlodhje,

	mjedise sportive, mjedise për këshillin dhe klubet studentore. <i>[Lista e shtojcave: Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Tabela 16)]</i>			
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ nga vizita në institucion konstaton se çdo klasë ka kompjuter dhe videoprojektor funksional dhe akses të përhershëm interneti. Çdo auditor sipas lëndës apo modulit të zhvilluar është i pajisur me smartboard dhe sisteme projektimi digjital, tabelë për të shkruar si dhe të gjitha mjetet e nevojshme ndihmëse kancelarike. Sallat kanë hapësirën e nevojshme për të ushtruar mësimdhënien në kushte të mira dhe komode për studentët. Secili mjedis disponon ajrosjen dhe ndriçimin e duhur, sistem mbrojtje nga zjarri edhe ajër të kondicionuar. Ambjentet janë të pajisura me banka dhe karrige komode për t'ju përgjigjur edhe qëndrimit me orë të zgjata në leksione dhe seminare të studentëve. <i>[Vizita GVJ në institucion]</i>			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	KU "Beder" për lëndët dhe programet e IT ka infrastrukturë të përshtatshme teknologjike me 2 laboratorë kompjuterash. Të gjithë kompjuterat janë arkitekturë ëorkstation me parametra të lartë teknike, ndërsa shpejtësia e transmetimit të rrjetit të brendshëm është 1Gb/Sek. Nga sa më sipër laboratorët mundësojnë aplikimin në praktikë të njohurive teorike. <i>[Vizita GVJ në institucion]</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	GVJ vizitoi 2 laboratorët informatikës dhe 1 të multimedias dhe pohon se ato përmbushin nevojat e programit të studimit profesional "Programim në Web". <i>[Vizita GVJ në institucion]</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se në KU "Bedër, infrastruktura përmbush nevojat e programit të studimit profesional "Programim në Web", për realizimin e procesit mësimdhënës dhe të formimit praktik të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Literatura bazë dhe	Një pjesë e konsiderueshme e literaturës bazë dhe ndihmëse, në format

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 37

<p>ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>fizik dhe digjital, ndodhet në bibliotekën e KU “Beder” në hapësirën e dedikuar fushës së teknologjisë së informacionit në mënyrë që studentët të mund të kenë akses të menjëhershëm sipas nevojave. [Lista e shtojcave: Të dhëna për platformat online/ Bibloteka (Tabela 17)]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e KU “Beder” ka filluar të japë shërbim që në kohën e themelimit të këtij Institucioni. Eshtë e konceptuar dhe e implementuar në hapësirë me 24 poste leximi, dhe 8 kompjutera në dispozicion. Në bibliotekë gjenden 22600 tituj shkencorë, 26000 libra, 166 monografi dhe 48 revista shkencore. GVJ-s j’u vu në dispozicion programi qe information kërkimin automatic të çdo artikulli. Bibloteka është e abonuar ne revista shkencore on-line si Jstore që lejon përdorimin e më shumë se 12 milion artkuj të revistave shkencore. Biblioteka e KU “Beder” mundeson komunikimin dhe në Book Academic Collection [Evidenca nr.35: Marrëveshja për akses në JTORE] [Vizita GVJ në institucion-Takim në Biblotekë]</p>
<p>Kriteri 3. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e KU “Beder” është e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Ne vërejmë se Bibloteka mbulon të gjitha modulet e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. Biblioteka është në dispozicion të studentëve, për të gjithë kohëzgjatjen e orarit zyrtar të punës së institucionit. Orari i hapjes dhe mbylljes së bibliotekës është 08.30 – 19.00, por në periudhën e provimeve qëndron dhe e hapur edhe gjatë fundjavës. [Vizita GVJ në institucion-Takim në Biblotekë]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ në vizitën e tij në Biblotekë, konsaton se studentët dhe pedagogët kanë akses të barabartë e pa pagesë në bibliotekën digjitale online JSTOR, që siguron qasje në më shumë se 12 milion artikuj të revistave akademike, libra dhe burime kryesore në 75 disiplina. Për të lehtësuar kërkimin shkencor është realizuar abonimi me databazë elektronike online. Siç u tha edhe më lart Bibloteka e KU “Beder” mundeson komunikimin dhe në Book Academic Collection. [Vizita GVJ në institucion-Takim në Biblotekë]</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë</p>	<p>GVJ konsaton se Biblioteka është e pajisur me poste leximi dhe pajisje kompjuterike, për ofrimin dhe aksesimin në bibliotekën digjitale të universitetit dhe të bibliotekave online ndërkombëtare duke përbushur nevojat e studentëve.</p>

shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.	<i>[Vizita GVJ në institucion-Takim në Bibliotekë]</i>		
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka në KU “Beder” është në dispozicion të studentëve, për të gjithë kohëzgjatjen e orarit zyrtar të punës së institucionit. Orari i hapjes dhe mbylljes së bibliotekës është 08.30 – 19.00. Menaxhimi i librave të bibliotekës në KU “Beder” bëhet nëpërmjet platformës digjitale të menaxhimit të librit ku mundësohet menaxhimi i librave sipas kategorive të ndryshme, kontrollimi me lehtësi për lëshimin/kthimin. Platforma ofron të gjitha opsionet e nevojshme për anëtarët në mënyrë që procesi i kërkesave drejtuar bibliotekës të jetë sa më i lehtë. <i>[Vizita GVJ në institucion-Takim në Bibliotekë]</i>		
Kriteri 7. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.	Nga takimet, vizitat, që GVJ zhvilloi në institucion, vërehet një fryme bashkupunimi mes departamenteve e bibliotekës për rritjen e cilësisë së shërbimit të bibliotekës. Për të inkurajuar studentët, për të apasionuarit e librit, apo për të diskutuar rreth sfidave të librit në epokën moderne, librit përballë digjitalizmit, librit dhe teknologjisë, janë marrë fushata sensibilizuese për mbledhjen e librave. Një nismë tjetër që ka kontribuar në pasurimin e bibliotekës ka qenë dhe dhurimi shumë librave nga ambasada Amerikane.		
Konkluzione	<i>Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit garantojnë literaturë të mjaftueshme (fizike dhe digjitale) për marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit si dhe mjedise të përshtatëshme për shfrytëzimin e kësaj literature.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë	GVJ konstaton se institucioni disponon një sistem të plotë menaxhimi administrativ, pranimi, informacioni, orientimi, këshillimi, mbështetjeje sociale dhe universitare. Me anë të systemit BIS

<p>informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.</p>	<p>realizohet automatizimi i gjithë sistemit të informacionit në KU “Beder”. Në modulet e sistemit BIS janë të ruajtura të dhënat dhe rekordet për secilin student, që nga momenti i regjistrimit deri në diplomim duke ndjekur në këtë mënyrë hap pas hapi ecurinë akademike të tyre. Studentët në takim me GVJ pohojnë se janë të informuar në kohë reale lidhur me rezultatet e tyre akademike, informacion mbi lektorët dhe të dhëna të tjera me rëndësi për ta.</p> <p>Në sistem kanë llogari të gjitha njësitë njësitë e organikës së brendshme si: stafi administrativ dhe akademik, sekretaria mësimore, zyra e rekrutimit dhe pranimit, dekanati i studentëve, klubet studentore si dhe të gjithë organizmat e tjerë duke ofruar informacion të rëndësishëm e të vlefshëm për studentët duke i mbështetur ata profesionalisht në çdo hap të formimit të tyre akademik, social dhe studentor.</p> <p><i>[Evidenca nr.36: Udhëzues I Sistemit Informativ Beder (BIS)]</i></p> <p><i>[Evidenca nr.40: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë]</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Zinxhiri i sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit, përbëhet nga: Studentët, Stafi akademik, Zyra e Burimeve Njerëzore, Sekretaria e Përgjithshme, Sekretaritë e Departamenteve, Zyra e Financës dhe Çështjeve administrative, Biblioteka, si dhe të gjithë organizmat e tjerë që funksionojnë në KU “Beder”.</p> <p>GVJ vizitoi këto njësi, të cilat realizojnë të gjitha proceset, aktivitetet dhe veprimtaritë e domosdoshme të administrimit të institucionit.</p> <p>Ky sistem rregullon dhe sistemon veprimtarinë e proceseve si: përgatitja dhe monitorimi i orareve mësimore, kontratat e punës, formularët e matjes dhe vlerësimit të performancës, formularët dhe programi i ngarkesës mësimore, etj.</p> <p><i>[Vizita GVJ në institucion]</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Eshte lehtësisht e konstatueshme se sistemi i menaxhimit informacionit BIS i ofron të gjithë personelit akademik dhe administrativ si dhe studentëve të vet, të gjithë informacionin e kërkuar dhe dokumentacionin e nevojshëm sipas statusit, pozicionit, interesit dhe qëllimit të kërkesës. Ky akses sigurohet nëpërmjet të drejtave në sistem të gjithsecilit, të përcaktuara këto sipas pozicioneve të punës apo funksionit në KU “Beder”.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga takimi GVJ me studentet mësohet se ato nëpërmjet sistemit BIS, kanë kontakte të vazhdueshme me pedagogët e lëndëve, koordinorët e programeve, në takime, seminare dhe ëorkshope, apo në çdo formë tjetër që lidhet me komunikimin ndërpersonal nëpërmjet sinkronizimit të të dhënave dhe përditësimit në kohë reale.</p> <p><i>[Vizita GVJ në institucion-Takim me studentët]</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e</p>	<p>Konstatohet se nëpërmjet sistemit BIS, kryhet monitorimi i aktivitetit akademik dhe administrativ në kohë reale. Monitorimi realizon raportimin e të dhënave të sinkronizuara drejt titullarit direkt,</p>

administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	burimeve njerëzore dhe zyrës së performancës. GVJ mendon se sistemi i menaxhimit garanton raportimin në kohë reale me funksionalitet të aktivitetit akademik dhe administrativ.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.	Lehtësisht verifikohet se faqet zyrtare të internetit të institucionit janë të plotësuara në kohë reale dhe rifreskohen disa herë në ditë duke mbajtur të përditësuar të gjithë informacionin e duhur mbi programet e studimit, organizimin, aktivitetet e ndryshme të institucionit, njoftime për praktikant profesional etj. Informacioni jepet në shqip dhe anglisht.			
Konkluzione	Në KU "Beder", me anë të sistemit BIS realizohet automatizimi i gjithë sistemit të informacionit i cili monitoron gjithë aktivitetin akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ vizitoi Zyren e Financave, dhe sipas rregullores, KU "Beder" harton çdo vit një raport financiar të detajuar të kostove të programit të studimit të shpenzimeve dhe të ardhurave. KU "Beder" ka statusin e një institucioni të lartë jofitimprurës. Ne takim, GVJ mëson se një mbështetje e madhe financiare janë donacionet. Një pjesë e madhe e studentëve në takim me GVJ pohojnë se janë të financuar me bursë nga institucioni.
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet	Referuar Raportit vjetor institucional të KU "Beder" në pasqyrimin e financimeve dhe menaxhimit të burimeve përmbahen të gjitha pikat e planit të financimit të një programi studimi. Ai paraqet në mënyrë të detajuar të dhënat e të gjithë shpenzimeve dhe të ardhurave. Paraqet një pasqyrë të qartë të granteve dhe kontratave që institucioni ka lidhur për praktikant dhe realizimin e programit të studimit. GVJ konsaton se plani financiar detajon me të gjithë hallkat e planit të financimit, jo vetëm në përmbushje të ecurisë konkrete të mbarëvajtjes së institucionit dhe programit të studimit por duke përmbushur në kohë të gjitha detyrimet kontraktuale nga marrëveshje dhe kontrata me të tretë.

financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	[RVB, Tabela 18] [Faqe web: Raporti vjetor institucional 2019-2020 https://www.beder.edu.al/sh/fcontent/default/raporti-vjetor--14-3/188/687]			
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Sipas RVB dhe takimeve në institucion çdo vit fondacioni, harton një raport, nga një kontabilist i miratuar, të situatës financiare dhe ky raport ruhet pranë fondacionit. [Dok DVV RVB Programim ne Web 2023]			
Kriteri 4. Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	KU “Beder” paraqet çdo fund viti akademik Ministrisë Arsimit dhe Sportit raportin vjetor institucional ku përfshihet buxheti vitit kaluar, projekt buxheti i vitit të ardhshëm akademik si dhe projekt buxheti afatmesëm. Të ardhurat kryesore të Kolegjit Universitar “Bedër” vijnë nga arkëtimet e studentëve, nga konsulencat/shërbimet dhe donacionet. Nga dokumentacioni i dorëzuar dhe faqia e Web-it nuk ka informacion të detajuar të viteve të fundit, 2020 e në vazhdim. GVJ rekomandon që ky informacion të shtohet. [RVB, Tabela 18] [Faqe web: Raportii vjetor institucional 2019-2020 https://www.beder.edu.al/sh/fcontent/default/raporti-vjetor--14-3/188/687]			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	GVJ mendon se Institucioni ka qëndrueshmëri financiare dhe kapacitetet financiare gjate kohës së zhvillimit të programit të studimit si dhe me mbështetjen e donatorëve ka kapacitete të duhura për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen			
Konkluzione	GVJ konstaton se KU “Bedër, ka një mbështetje të madhe financiare nga donacionet, garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programit të studimit profesional “Programim në Web”.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në KU “Beder”, procesi nga pranimi i studentëve deri në diplomimin e tyre mbështetet në legjislacionin në fuqi, dhe rregulloren akademike. GVJ konstaton se Institucioni kujdeset për informimin e studentëve nëpërmjet sistemit BIS ku në këtë platformë kryhet në kohë reale komunikimi i brëndëshëm dhe njoftimet e duhura për mbarëvajtjen e procesit nga hyrja deri në diplomim. [Evidenca nr.40: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë] [Evidenca nr.51: Performanca e studentëve nga zyra sekretarisë mësimore] [Evidenca nr.8: Guida e studentit] [Evidenca nr. 15: Rregullorja Themelore]
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Nga gjithë vizita e GVJ në KU “Beder”, pohojmë se kriteret dhe procedurat nga hyrja në dalje janë transparente për të gjithë, duke garantuar barazi dhe të drejta të barabarta për kandidatët dhe studentët e programeve të studimit. KU “Beder” mbështet studentët me aftësi të kufizuar dhe i siguron atyre edhe mbështetje financiare, e në disa raste deri në masën 100%. Në KU “Beder” pranimi bëhet mbi bazen e rregullave në fuqi, rregulloren e institucionit, rregulloren e programit, të cilat janë publike në faqen zyrtare të institucionit. Po ashtu edhe kalimi nga një vit akademik në tjetrin bëhet si pas rregullores. [Evidenca nr.40: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë, neni 33] [Evidenca nr.14: Rregullorja e programit me karakter profesional “Programim në Web”]
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Janë lehtësisht të aksesueshme, transparente dhe publike, kriteret, procedurat e pranimit të përzgjedhjes së studentëve, si dhe kërkesat e tyre për transferim. GVJ mendon se kriteret janë të mirëmbledhura si: 1. Mesatarja e shkollës mesme në masën 70%. 2. Intervista nga komisioni më masën 30%. Çdo i interesuar mund t’i aksesojë ato si në faqen zyrtare të internetit të Universitetit, ashtu dhe në portalin U-Albania, për të qenë të aksesueshme për të gjithë. [Evidenca nr.33: Vendimi I senatit akademik për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve për programet e studimit.]
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit për gjatë kursit të studimit, të transferimit,	Kriteret, procesi i pranimit, procedurat e regjistrimit e të përzgjedhjes së studentëve, si dhe kërkesat e tyre për transferim janë lehtësisht të aksesueshme, transparente dhe publike. Çdo i interesuar mund t’i aksesojë ato si në faqen zyrtare të web të Universitetit, edhe nëpërmjet

njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	komunikimeve direkte me/ në zyrat përkatëse të sekretarive të departamentëve, sekretarisë mësimore, apo zyrës së pranimit. <i>[Vizita e GVJ ne institucion]</i>			
Kriteri 5. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ konstaton se procesi i regjistrimit dhe aplikimit kryhet në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Çdo i interesuar mund t'i aksesojë ato në faqen zyrtare të Web të Universitetit.			
Kriteri 6. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Nga takimet e GVJ me studentët, ato pohojnë se KU “Beder” ofrohen bursa të ndryshme studimi, të plota ose të pjesshme për shtresat në nevojë, studentëve me aftësi ndryshe, studentëve të talentuar, studentëve me rezultate të shkelqyera. <i>[Vizita e GVJ ne institucion Takimi me studentet]</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se KU “Beder, harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, për njohjen dhe vlerësimin e dijeve në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ vëren se në rregulloren e programit të studimit janë parashikuar procedurat dhe informacion i detajuar lidhur me të gjithë procesin dhe përparimin akademik. Në rregullore dhe konkretisht në Guidën e studentit parashikohen të drejtat dhe detyrat e studentëve, dokumentimi i vlerësimeve, komunikimi i vlerësimeve, zhvillimi i provimeve, e drejta për të hyrë në provim, kritere dhe procedura të vlerësimit, transferimi i studimeve, ndërprerja dhe rifillimi i studimeve etj. Nga takimet me studentët, GVJ mëson se studentët gjithashtu informohen në detaje lidhur me secilën prej procedurave të përmendura, përmes sekretarisë departamentit dhe sekretarisë mësimore. Ata gjithashtu janë të informuar për vlerësimet për secilën lëndë të zhvilluar gjatë gjithë vitit akademik, për numrin e krediteve të

	<p>akumuluar për të kaluar nga një vit akademik në tjetrin, etj. Këto informacione merren edhe në rregulloren e programit, rregulloren e ciklit të parë të studimeve, kontratën e studentit dhe rregulloren themelore.</p> <p><i>[Evidenca nr.8: Guida e studentit]</i> <i>[Evidenca nr.52: Shembull kontratë studimi]</i> <i>[Evidenca nr.14: Rregulloreprogramit me karakter profesional "Programim në Web"]</i> <i>[Evidenca nr. 15: Rregullorja Themelore]</i> <i>[Evidenca nr.40: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>KU "Beder" pranon transferime të studentëve nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në institucione të tjera të arsimit të lartë. Njohja e krediteve bëhet nga një komision i posaçëm i cili vendos për procesin e transferimit. Gjithashtu ky komision kryen të gjitha procedurat e ekuivalentimit të lëndëve dhe programeve. GVJ pohon se institucioni informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p> <p>E gjithë procedura e transferimit të studentëve dhe ekuivalentimit parashikohet në Rregulloren e Transferimeve.</p> <p>Në KU "Beder" studentët paisen me diplomë vetëm pasi kanë ndjekur jo më pak se 2 semestra në KU "Beder".</p> <p><i>[Evidenca nr.53: Vendimi për ngritjen e komisionit për vlerësimin dhe përzgjedhjen e studentëve]</i> <i>[Evidenca nr.32: Rregullorja e transferimit të studimeve]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Në takim me GVJ, studentët pohojnë se janë të informuar në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve në programin e studimit. Në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar kriteret dhe format e vlerësimit të dijeve të studentëve, e drejta për të hyrë në provim, zhvillimi i provimeve, komunikimi i vlerësimeve dhe dokumentimi i vlerësimeve.</p> <p>Studentët njihen me kreditet, vlerësimin, modulet nga pedagogu i lëndës që në prezantimin e lëndës. Gjithashtu edhe nga sistemi BIS studentët marrin informacionin e nevojshem në kohë reale. Nga shqyrtimi i çdo syllabusi duket qartë se aty janë përcaktuar format e vlerësimit të dijeve në mënyrë të detajuar.</p> <p><i>[Evidenca nr.31: Shembull syllabusi]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Nëse do shikojmë rregulloren e programit të studimit, aty janë të shprehura qartë kriteret e diplomimit të studentëve.</p> <p>Ne takim me GVJ, studentët pohojnë se janë të informuar për procedurat dhe gjithë procesin e diplomimit.</p> <p>Në programin e studimit profesional "Programim në Web" detyrimet për diplomim konsiderohen të përfunduara pasi përmbushen detyrimet sipas planit mësimor.</p> <p><i>[Evidenca nr.14: Rregullore programit me karakter profesional "Programim në Web"]</i></p>

	[Evidenca nr. 15: Rregullorja Themelore] [Vizita e GVJ ne institucion - Takimi me studentet]			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	KU “Beder” zbaton një politikë të organizuar rekrutimi të studentëve të ardhshëm. Aty përfshihen pjesëmarrje në panairë, katalogje, vizita të stafit të KU “Beder” në shkollat e mesme duke prezantuar me detaje kriteret e pranimit në secilin program studimi, konkurset, bursat, etj. Studentët, në fillim të vitit të ri akademik, prezantohen me ambientet, stafin akademik dhe atë mbështetës që Javën e Orientimit që KU “Beder” zhvillon, në çdo vit të ri akademik. [Ev. nr. 33: Vendimi i senatit akademik per miratimin e kriterëve te pranimit te studenteve ne programin “Programim në Web”]			
Konkluzione	GVJ konstaton se KU “Bedër, vë në dispozicion informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Nga takimi GVJ me studentët, mesohet se ata janë të informuar në mënyrë të detajuar për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programin e studimit. Që gjatë periudhës së regjistrimit dhe gjatë javës së parë të akomodimit, personeli akademik bëjnë prezantimin e programit të studimit. Gjithashtu edhe në Rregulloren e programit të studimit jepet informacion i detajuar për cdo detaj të programit të studimit. Të dhëna të detajuara, për programin e studimit jepen edhe nëpërmjet sistemit BIS, guidës studentit edhe në faqes Web të institucionit. [Evidenca nr.14: Rregullore programit me karakter profesional “Programim në Web”] https://beder.edu.al
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Si dhe në kriterin 1, Studentët e këtij program studimi marrin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me modulet, lëndët dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit kryesisht nëpërmjet sistemit BIS dhe faqes internetit. Në këtë faqe gjendet Guida Studentit, që prezantohet në ditët e orientimit nga ku studentët infromohen hollësisht për çdo detaj të programit të studimit.

	<i>[Evidenva nr.8: Guida e studentit]</i>			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	GVJ bëri vizitë dhe ne zyrën e Planifikimit të Karrierës” e cila orienton studentët në tregun e punës. Kështu studentëve i ofrohet ndihmesë në qartësimin e programit të studimit dhe mënyrën se si studentët mund të orientojnë studimet e tyre drejt një punësimi të suksesshëm. Po ashtu në KU “Beder” funksionon dhe Këshilltari i Karrierës i cili ndihmon studentët për informacione për vende pune, si të kryejnë intervistat e punës që të jene të suksesshëm etj. <i>[Evidenva nr.22: Vendimi i këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë zyrës Planifikimit Karrierës]</i>			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Nga takimi me studentët pohohet se, ato kanë në dispozicion një informacion të gjerë dhe të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet. Këshilltarët akademik dhe Koordinatorët e programeve mbajnë kontakte të rregullta me studentët që ndjekin programin e studimit, nëpërmjet komunikimeve elektronike dhe portalit BIS. Po ashtu studentët pohojnë se janë informuar edhe në ditët e orientimit për mjediset, klasat, laboratorët, bilbotekën, lektorët, këshilltarët akademikë etj. Po ashtu nga vizita GVJ në sekretarinë mësimore, vërejmë se kjo e fundit njofton studentët, për çdo ndryshim në orar, apo ndryshim gjatë zbatimit të tij. Gjithashtu studentëve njoftohen në kohë reale, nëpërmjet sistemit BIS për çdo informacion tjetër në lidhje me procesin mësimor, kalendarin akademik dhe aktivitete të ndryshme mësimore që organizohen në KU “Beder”. <i>[Evidenva nr.23: Vendimi i këshillit të Departamentit për caktimin e këshilltarit akademik]</i> <i>[Vizita e GVJ në institucion - Takimi me studentet e programit “Programim në Web”]</i>			
Kriteri 5. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	GVJ konstaton se KU “Beder” përgatit studentët me njohuri të nevojshme për të arritur një karrierë profesionale në të ardhmen. Po ashtu, Dekani i Studentëve dhe përfaqësuesi i Zyrës së Alumnit dhe Karrierës ndihmojnë, përmes takimeve të ndryshme në qartësimin e programeve të studimit dhe mënyrën se si studentët mund të orientojnë studimet e tyre drejt një punësimi të suksesshëm. <i>[Vizita e GVJ në institucion]</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se KU “Bedër, vë në dispozicion informacion të plotë në lidhje me strukturën, organizimin, syllabuset, përmbajtjen e programit të studimit “Programim në Web”, si dhe për hapat drejt punësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Në KU “Beder” ka një bazë të dhënash të detajuara në lidhje me studentët e regjistruar në programin e studimit me karakter profesional “Programim në Web”, studentët e transferuar apo ata që kanë ndërprerë studimet për një periudhë afatshkurtër si edhe ata që janë çregjistruar.</p> <p>GVJ bëri vizitë në Sekretarinë Mësimore, kontrolloi regjistrat, ku ekzistonin të dhëna të sakta në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar në çdo vit akademik, përfundimin apo jo të programit të studimit, si dhe për numrin e të diplomuarve.</p> <p><i>[Vizita e GVJ në sekretarinë mesimore]</i></p>
<p>Kriteri 2. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Në KU “Beder” funksion platforma BIS, platformë ku pasqyrohen të dhënat mbi: notat dhe rezultatet e provimeve, datën e zhvillimit të provimit, etj. Kjo u mundëson studentëve të informohen në kohë reale lidhur me rezultatet e tyre akademike dhe të dhëna të tjera me rëndësi për ta.</p> <p>GVJ vizitoi sekretarinë mësimore, në të cilën ndodhen dosjet e secilit student, e cila përpunon këto të dhëna dhe i raporton në instancat përkatëse sipas kërkesës. <i>[Vizita e GVJ në sekretarinë mesimore]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësisve përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Siç theksuam më lart në platformën BIS gjenden të dhëna mbi notat, lëndët e dhëna provim si dhe menaxhohen të gjithë të dhënat e studentëve.</p> <p>Në sekretari çdo student ka dosjen e tij, ku përmbahen të dhënat për ecurinë e studimeve dhe rekordet e studentit. GVJ konstaton se të dhënat e studentit dhe performancës së studentit gjenden në Sekretarinë Mësimore.</p> <p>Dosjet dhe vërtetësia e tyre verifikohen nga komisione të cilat kryejnë auditimin periodik të brendshëm.</p> <p><i>[Evidenca nr.44: Proçedura për auditimin periodik të brendshëm]</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilit dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Nga vizita GVJ në KU “Beder”, mesohet se institucioni realizon për çdo vit akademik një raport analitik, kur prezanton cilësinë e studentëve, rezultatet e arritura prej tyre, si dhe realizimin e objektivave. Nga takimet me studentët mësohet gjithashtu se çdo grup studentësh ka një këshilltar akademik, i cili udhëzon studentët mbi anën akademike, miraton formularët e regjistrimit etj.</p> <p>Gjithashtu dhe nga vizita në Zyrën Alumni dhe Karriera mësohet se ruhen komunikime të shpeshta me të diplomuarit e tyre lidhur me ecurinë e tyre në tregun e punës dhe mbështetjen e mëtejshme nëpërmjet kualifikimit të vazhduar apo edhe paraqitjen e mundësive</p>

	për punësim. Në këtë program studimi nuk ka ende të diplomuar. [Evidenca nr.51: Performancat e studentit nga zyra Sekretarisë Mësimore.]			
Konkluzione	GVJ konstaton se nëpërmjet Sekretarisë Mësimore, platformës BIS, KU "Bedër, administron, përditëson, ruan të gjithë të dhënat studentëve nga hyrja deri në diplomim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>Studentët në takim me GVJ pohojnë se, janë të përfshirë në strukturat kryesore dhe organet vendimmarrëse e këshilluese si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Senatin Akademik; • Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë; • Dekanatin e Fakultetit; • Këshillin/qeverinë e studentëve; • Mbledhjet e departamenteve. <p>Në KU "Beder" është dhe struktura e Dekanit të Studentëve që mission kryesor ka orientimin, këshillimin dhe mbrojtjen të drejtave të studentëve. GVJ pohon se me vendim senatit akademik parashikohet përfshirja dhe angazhimi i studentëve në organe vendimmarrëse, si dhe inkurajohet pjesëmarrja e studentëve në vendimmarrje, organizimin e lirë, dhe shprehjen e mendimit të tyre.</p> <p>[Evidenca nr. 39: Vensimi i Senatit Akademik për studentët përfaqësues në mbledhje] [Vizita e GVJ në Institucion-Takim me studentët]</p>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	<p>Studentët pohojnë se janë të përfshirë edhe në vlerësimin e procesit akademik. GVJ vizitoi Njësinë e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, ku dhe pa dokumentacionin e anketimit i cili bëhet dy herë në vit. Në këtë anketim mblidhen të dhëna për secilën lëndë, secilin pedagog dhe studentët mund të japin mendimet e tyre lidhur me proceset mësimore, metodat e mësimdhënies etj.</p> <p>Në varësi të këtyre rezultateve departamentet marrin masa për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> <p>[Evidenca nr.45: Anketa e studentit ndaj lëndës]</p>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse	Përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe

garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	përmirësimit të programeve të studimit realizohet përmes pyetësorëve të studentëve. GVJ shqyrtoi disa pyetësorë në Njësinë e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë, të cilat zhvillohen dy javë përpara mbarimit të çdo semestri si dhe raportin vjetor. Në këto raporte një rëndësi i kushtohet analizës SWOT.			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës.	Përfshirja e studentëve në procesin e vlerësimit realizohet përmes pyetësorëve të studentëve që realizohen në systemin BIS. Proçesi është anonim dhe përpunohet në mënyrë automatike dhe transparente. Nëqoftëse nga studenti kërkohet rishikim i provimit atëherë ngrihet një komision i posatshtëm për rivlerësim. <i>[Vizita e GVJ ne institucion - Takimi me studentet]</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se nëpërmjet pyetësorëve, anketimeve, platformës BIS, KU “Beder, u mundëson studentëve dhënien e mendimit mbi përmirësimin e programit të studimit, metodave të mësimdhënies, kontrollit të dijeve dhe shprehjes së lirë të mendimit të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Grupi Vlerësimit Jashtëm vërteton se, në KU “Beder” funksionojnë Zyra e Pranimit, Sekretaria Mësimore, Dekani i Studentëve, Zyra e Alumni dhe Karrierës dhe Koordinatori i Departamentit të cilat janë njësitë e posaçme me qëllim informimin dhe shërbimin e studentëve. Këto njësi ndjekin ecurinë e studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar këshillim për çështje akademike në shërbim të procesit mësimor, si dhe ato studentore. Gjithashtu në fillim të çdo semestri çdo lektor paraqet syllabusin e lëndës ku jepet gjithë informacioni për lëndën. <i>[Vizita e GVJ ne institucion]</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit	KU “Beder” vë në dispozicion një sërë strukturash për të informuar dhe ndjekur ecurinë e procesit akademik të programit të studimit “Programim në Web”. Këtu përfshihen zyra e këshillimit të karrierës, seminarët e hapura dhe këshilltari akademik i cili ka kontakt të

të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	drejtpërdrejtë me studentet duke ndjekur ecurinë e tyre dhe duke marrë opinione të vazhdueshme përgjatë studimeve. <i>[Vizita e GVJ ne institucion- Takimi me studentët]</i> <i>[Ev. nr. 23: Vendim i Keshillit te Departamentit per miratimin e keshilltarit akademik.</i>			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Planifikimit të Karrierës është njësi përkatëse që mbështet dhe informon studentet përgjatë periudhës së studimeve deri në daljen e tyre në tregun e punës. Kjo njësi luan rolin e ndërmjetësit duke i këshilluar dhe orientuar studentet që të shfrytëzojnë mundësitë në tregun në përputhje me profilin e tyre. Keshilltari i karrierës si përfaqësues i kesaj zyre, luan një rol të rëndësishëm në orientimin e studentëve për të zhvilluar praktikat profesionale dhe për t'u përshtatur në tregun e punës. <i>[Vizita e GVJ ne institucion -Takimi me studentët]</i> <i>[Vizita e GVJ ne institucion -Takimi me përfaqësuesit të Zyrës së Planifikimit të Karrierës]</i>			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Zyra e Planifikimit të Karrierës kujdeset për të mbajtur kontakte të vazhdueshme me studentët edhe pas diplomimit të tyre, duke krijuar një strukturë informacioni mbi punësimin e studentëve dhe karrierën në vazhdim. KU "Beder" ka ngritur dhe zyrën e të diplomuarve, që është në varësi të dekanit të studentëve, por për programin "Pogramim në Web" nuk ka student të diplomuar, ndaj kjo do të realizohet në të ardhmen. <i>[Vizita e GVJ në institucion- Zyra Planifikimit Karrierës]</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se nëpërmjet Zyrës Pranimi, Sekretarisë Mësimore, Zyrës Alumni dhe Karrierës, KU "Bedër, informon dhe shërben studentëve për pritjen, orientimin, këshillimin dhe menaxhimin e problematikave të tyre .</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në “Programim në Web” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar Bedër”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi është hartura mbi bazën e një studimi të detajuar të kërkesës dhe ofertës së tregut duke u bazuar mbi eksperiencat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu është hartuar mbi bazën e një vizioni për një plani të qartë të zhvillimit strategjik të vëndit.
2. Personeli akademik efektiv i angazhuar ka eksperiencë në program të mëparshme të niveleve të tjera.
3. Personeli akademik me kohë të pjesshme janë ekspert të fushës, me njohuri që lidhen dhe me kurrikulën e programit.
4. Institucioni organizon veprimtari dhe aktivitete në mbështetje të programit të studimit (konferenca, leksionet e hapura, trajnime, konkurse, etj.)
5. KU "Bedër", ka marrëdhënie bashkëpunimi ndërinstitucionale me institucione shtetërore dhe IAL brenda vëndit, si dhe me kompani dhe zyra, pjesë e komunitetit të biznesit ose tregut të punës.
6. Sistemi i automatizimit (BIS) i cili administron të dhënat për personelin dhe studentët rrit cilësinë e shërbimeve dhe transparencën në institucion.
7. Mbështetja me disa kategori burasash si për studentët ekselent ashtu edhe bursat sociale.
8. Institucion i përfshin studentët në organet e vendimarrjes si dhe i mbështet ata në planifikimin e karrierës.

Pika të dobta:

1. Literaturat në programet lëndore janë në përgjithësi më të vjetra se 5 vite.

Rekomandime:

1. Biblioteka të pasurohet më tepër me tekste bashkëkohorë për lëndët krakterizuese të programit.
2. Shtimi i numrit të laboratoreve dhe posteve të punës për studentët.

Evaluation's conclusions for the professional study program " Web Programming" provided by the Higher Education Institution " Bedër University College"

Strengths and affirmations:


1. The program is designed on the basis of a detailed study of the demand and supply shown by expressing the best national and reporting experiences. is designed on the basis of a vision for a clear plan of its design.
2. The effective academic staff has experience in the previous program of other levels.
3. Part-time academic personnel, experts in the field, with knowledge related to the curriculum of the program.
4. Institutional organization of activities and activities in study programs (conferences, open lectures, trainings, competitions, etc.)
5. Bedër University College has inter-institutional cooperation with state institutions and HEIs within the country, as well as with companies and offices, part of the business or work community.
6. The Automation System (BIS) which manages personal data and increases other characteristics and transparency in the institution.
7. Support with several categories of scholarships for both excellent students and social scholarships.
8. The institution is available to the received bodies as well as supports them in the work plan.

Weaknesses:

1. The literature in the subject programs is generally older than 5 years.

Recommendation:

1. The library should be enriched more with contemporary texts for the subjects characterizing the program.
2. Increasing the number of laboratories and work stations for students.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X